

**TIRANA INTERNATIONAL AIRPORT SH.P.K.**

**Raporti i audituesit të pavarur  
dhe Pasqyrat Financiare më dhe  
për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020**

## PËRMBAJTJA

RAPORTI I AUDITUESIT TË PAVARUR .....	4
PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR.....	1
PASQYRA E FITIMIT OSE HUMBJES DHE TË ARDHURAVE TË TJERA GJITHPËRFSHIRËSE ...	2
PASQYRA E NDRYSHIMEVE NË KAPITAL .....	3
PASQYRA E FLUKSEVE TË PARASË .....	4
1. SHOQËRIA OPERUESE .....	5
1.1 INFORMACION I PËRGJITHSHËM.....	5
1.2 KONTRATA E KONCESIONIT .....	5
2. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE BAZË KONTABËL.....	7
3. PËRDORIMI I VLERËSIMEVE DHE GJYKIMEVE.....	24
5. MANAXHIMI I RREZIKUT FINANCIAR.....	26
6. AKTIVE TË TRUPËZUARA, NETO .....	29
7. AKTIVE TË PATRUPËZUARA, NETO DHE PUNIME NË PROÇES .....	30
8. TATIM FITIMI I PARAPAGUAR .....	31
9. LLOGARI TË ARKËTUESHME, NETO.....	31
10. AKTIVE TË TJERA.....	32
11. PARA NË ARKË DHE BANKË.....	32
12. KREDI BANKARE DHE HUA TË TJERA.....	33
13. LLOGARI TË PAGUESHME.....	34
14. PALË TË LIDHURA .....	35
15. PROVIGJION PËR DETYRIMET KONÇENSIONARE .....	36
16. TARIFA E PAGUESHME E KONCESIONIT .....	36
17. DETYRIME TË TJERA.....	37
18. KAPITALI THEMELTAR.....	38
19. TË ARDHURA.....	38
20. SHPENZIME PERSONELI .....	40
21. SHPENZIME TË PËRGJITHSHME DHE ADMINISTRATIVE.....	40
22. SHPENZIME FINANCIARE, NETO .....	41
23. TATIMI MBI FITIMIN.....	41
23.1 Tatimi i shtyrë aktiv dhe pasiv .....	41
23. TATIMI MBI FITIMIN (VAZHDIM) .....	42
23.2 Shpenzimi i tatimit mbi fitimin.....	42
24. INSTRUMENTAT FINANCIARË.....	43
24.1 Rreziku i kredisë .....	43
24.2 Rreziku i likuiditetit.....	45
24.3 Rreziku i kursit të këmbimit.....	47
24.4 Rreziku ndaj normës së interesit .....	49
24.5 Ndryshimet në detyrimet që lindin nga anktiviteti financiar .....	49
25. ANGAZHIME DHE PASIGURI.....	50
26. NGJARJE PAS PERIUdhËS RAPORTUESE .....	50

## RAPORTI I AUDITUESIT TË PAVARUR

Për Aksionarin dhe Drejtimin e Tirana International Airport sh.p.k.

Raport për auditimin e pasqyrave financiare

### Opinionin

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të Tirana International Airport sh.p.k. ("Shoqëria"), që përfshijnë pasqyrën e pozicionit financiar më datë 31 dhjetor 2020, si dhe pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve, si dhe të ndryshimeve në kapital dhe të flukseve të parasë për vitin që mbyllet me këtë datë, si edhe shënimet për pasqyrat financiare, përfshirë një përmbledhje të politikave kontabël më të rëndësishme.

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare bashkëlidhur paraqesin drejt, në të gjitha aspektet materiale pozicionin financiar të Shoqërisë më 31 dhjetor 2020, dhe performancën financiare dhe fluksin e mjeteve monetare për vitin e mbyllur në këtë datë, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar Auditimit (SNRF).

### Baza për opinionin

Ne kemi kryer auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA-të). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në seksionin e raportit ku jepen Përgjegjësitë e Audituesit për Auditimin e Pasqyrave Financiare. Ne jemi të pavarur nga Shoqëria në përputhje me *Kodin Ndërkombëtar të Etikës për Profesionistët Kontabël* të Bordit të Standardeve Ndërkombëtare të Etikës për Profesionistët Kontabël (duke përfshirë Standardet Ndërkombëtare të Pavarësisë) (Kodi i BSNEPK) së bashku me kërkesat etike që janë të zbatueshme për auditimin e pasqyrave financiare në Shqipëri, dhe kemi përmbushur përgjegjësitë e tjera etike në përputhje me këto kërkesa dhe me Kodin BSNEPK.

Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë një bazë për opinionin tonë.

### Përgjegjësitë e Drejtimit dhe të atyre të ngarkuar me qeverisjen për Pasqyrat Financiare

Ne e kemi kryer auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit ("SNA"-të). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në paragrafin Përgjegjësia e Audituesit për auditimin e pasqyrave financiare të veçanta të raportit tonë. Ne jemi të pavarur nga Shoqëria në pajtim me Kodin e Etikës për Profesionistët Kontabël të Bordit të Standardeve Ndërkombëtare të Etikës për Profesionistët Kontabël (përfshirë Standardet Ndërkombëtare të Pavarësisë) ("Kodi i BSNEPK") dhe me me Kodin e Etikës të Institutit të Ekspertëve Kontabël të Autorizuar të Shqipërisë ("Kodi IEKA"), së bashku me kërkesat etike të Ligjit Nr. 10091, datë 5 mars 2009 "Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe të kontabilistit të miratuar", të ndryshuar, që janë të përshtatshme për auditimin e pasqyrave financiare në Shqipëri, dhe kemi përmbushur përgjegjësitë tona të tjera etike në përputhje me këto kërkesa dhe me Kodin BSNEPK dhe Kodin IEKA.

Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë një bazë për opinionin tonë.

### Përgjegjësitë e audituesit për auditimin e pasqyrave financiare

Objektivat tona janë të marrim siguri të arsyeshme nëse pasqyrat financiare në tërësi nuk kanë anomali materiale, për shkak të mashtrimit apo gabimit, dhe të lëshojmë një raport auditimi që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është një siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci që një auditim i kryer në përputhje me SNA-të do të identifikojë gjithmonë një anomali materiale kur ajo ekziston.

## Përgjegjësitë e audituesit për auditimin e pasqyrave financiare (vazhdim)

Anomalitë mund të vijnë si rezultat i gabimit ose i mashtrimit dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose të marra së bashku, pritet që në mënyrë të arsyeshme të influencojnë vendimet ekonomike të përdoruesve, të marra bazuar në këto pasqyra financiare.

Si pjesë e një auditimi në përputhje me SNA-të ne ushtrojmë gjykimin profesional dhe mbajmë skepticizëm profesional gjatë auditimit. Ne gjithashtu:

- ▶ Identifikojmë dhe vlerësojmë rrezikun e anomalive materiale të pasqyrave financiare, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit, projektojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që i përgjigjen këtyre rreziqeve, dhe marrim evidenca auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të bazuar opinionin tonë. Rreziku i mos zbulimit të një anomalie materiale që rezulton nga mashtrimi është me i lartë sesa një që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë marrëveshje të fshehtë, falsifikim, mosdhënie e vetëdijshme e gjithë informacionit, keq përfaqësime, apo shkelje të kontrollit të brendshëm.
- ▶ Marrim një kuptim të kontrollit të brendshëm të lidhur me auditimin me qëllim hartimin e procedurave të auditimit të cilat janë të përshtatshme për rrethanat, por jo për qëllimin e shprehjes së një opinionimi mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm të Shoqërisë.
- ▶ Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e përlllogaritjeve kontabël dhe informacioneve të lidhura shpjeguese të bëra nga drejtimi.
- ▶ Duke u bazuar në evidencat e auditimit, nxjerrim përfundime mbi përshtatshmërinë e përdorimit nga ana e drejtimit të parimit të vijimësisë si bazë kontabël, nese ekziston një pasiguri materiale në lidhje me ngjarjet ose kushtet që mund të hedhin dyshime domethënëse në aftësinë e Shoqërisë për të vazhduar në vijimësi. Nëse arrijmë në përfundimin se një pasiguri materiale ekziston, ne jemi të detyruar të tërheqim vëmendjen në raportin tonë të auditimit tek informacionet shpjeguese të pasqyrave financiare ose nëse keto informacione shpjeguese janë të pamjaftueshme, të ndryshojmë opinionin tonë. Përfundimet tona të auditimit bazohen në evidencat e auditimit të marra deri në datën e raportit tonë të auditimit. Megjithatë, ngjarje ose kushte të ardhshme mund të shkaktojnë që Shoqëria të ndalojë së vazhduari në vijimësi.
- ▶ Vlerësojmë prezantimin e përgjithshëm, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare, duke përfshirë informacionet shpjeguese të dhëna, dhe nëse pasqyrat financiare paraqesin veprimet dhe ngjarjet e ndodhura në mënyrë që të arrijnë një prezantim të drejtë.

Ne komunikojmë me Drejtimin dhe personat e ngarkuar me qeverisjen e Tirana International Airport sh.p.k. përveç të tjerave, lidhur me qëllimin dhe kohën e auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë ndonjë mangësi të rëndësishme në kontrollin e brendshëm që ne mund të identifikojmë gjatë auditimit.

## Raport për Informacione të Tjera

Informacione të tjera përfshijnë informacione në Raportin Vjetor të Shoqërisë për vitin 2020, përgatitur në përputhje me nenet 17, 18 dhe 19 të Ligjit Nr. 25\2018 "Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare", përveç pasqyrave financiare dhe këtij raporti të audituesit. Drejtimi është përgjegjës për informacionet e tjera. Raporti Vjetor i Shoqërisë për vitin 2020 pritet të na vihet në dispozicion pas datës së këtij raporti të audituesit.

Opinionin ynë mbi pasqyrat financiare nuk mbulon informacionet e tjera dhe ne nuk shprehim ndonjë lloj konkluzioni që jep siguri në lidhje me këto informacione.

Në lidhje me auditimin tonë të pasqyrave financiare, ne kemi përgjegjësinë të lexojmë informacionet e tjera të identikuara më lart kur ato të na vihen në dispozicion dhe të vlerësojmë nëse këto informacione kanë inkoherenca materiale me pasqyrat financiare apo me njohjen që ne kemi marrë gjatë auditimit ose përndryshe, nëse duket se ato janë me gabime materiale.

Nëse bazuar në punën e kryer ne arrijmë në përfundimin se këto informacione përmbajnë gabime materiale, atëherë ne duhet të raportojmë për këtë fakt.

Ernst & Young - Ekspertë Kontabël të Autorizuar  
Dega në Shqipëri

31 Mars 2021  
Tiranë, Shqipëri




Mario Vangjel  
Auditues Ligjor

# TIRANA INTERNATIONAL AIRPORT SH.P.K.

## PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR më 31 dhjetor 2020

Shënime	31 dhjetor 2020 në Lek	31 dhjetor 2019 në Lek
<b>Aktivet</b>		
<b>Aktivet afatgjata</b>		
Aktive të trupëzuara, neto	6 384,708,348	439,890,432
Aktive të patrupëzuara, neto	7 4,797,928,344	4,478,291,218
Tatimi i shtyrë aktiv	23 414,750,570	380,282,195
<b>Totali i aktiveve afatgjata</b>	<b>5,597,387,262</b>	<b>5,298,463,845</b>
<b>Aktivet afatshkurtra</b>		
Tatim fitimi i parapaguar	8 140,222,686	50,183,655
Llogari të arkëtueshme, neto	9 1,580,683,798	1,668,691,049
Aktive të tjera	10 1,262,152,433	297,589,629
Para në arkë dhe bankë	11 812,990,247	3,023,565,701
<b>Totali i aktiveve afatshkurtra</b>	<b>3,796,049,164</b>	<b>5,040,030,034</b>
<b>Totali i aktiveve</b>	<b>9,393,436,426</b>	<b>10,338,493,879</b>
<b>Kapitali</b>		
Kapitali themeltar	18 1,161,148,883	1,161,148,883
Diferenca konvertimi	18 (239,449,284)	(339,104,889)
Fitime të mbartura	4,428,546,687	4,634,942,137
<b>Totali i kapitalit</b>	<b>5,350,246,286</b>	<b>5,456,986,131</b>
<b>Detyrimet</b>		
<b>Detyrimet afatgjata</b>		
Kredi bankare dhe hua të tjera	12 12,455,776	614,267,690
Detyrime të tjera	17 138,159,801	177,277,566
<b>Totali i detyrimeve afatgjata</b>	<b>150,615,577</b>	<b>791,545,256</b>
<b>Detyrimet afatshkurtra</b>		
Kredi bankare dhe hua të tjera	12 9,886,652	580,743,636
Llogari të pagueshme	13 261,194,999	289,788,925
Tarifa e pagueshme e koncensionit	16 886,965,492	747,551,144
Dividend i pagueshëm	587,575,000	-
Provizgjion për detyrimet koncesionare	15 677,938,711	676,115,308
Detyrime të tjera	17 1,469,013,709	1,795,763,479
<b>Totali i detyrimeve afatshkurtra</b>	<b>3,892,574,563</b>	<b>4,089,962,492</b>
<b>Totali i detyrimeve dhe kapitalit</b>	<b>9,393,436,426</b>	<b>10,338,493,879</b>

Këto pasqyra financiare u aprovuan nga Ortaku i Tirana International Airport Sh.p.k më datë 29 mars 2021 dhe u firmosën nga:

  
Dr. Constantin von Alvensleben  
Drejtor i Përgjithshëm Ekzekutiv

Pasqyra e pozicionit financiar duhet lexuar së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 5 deri në 50, që janë pjesë përbërëse e pasqyrave financiare.

**TIRANA INTERNATIONAL AIRPORT SH.P.K.****PASQYRA E FITIMIT OSE HUMBJES DHE TË ARDHURAVE TË TJERA  
GJITHPËRFSHIRËSE**

Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020

Shënime	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2020 në Lek	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2019 në Lek	
Të ardhura	19	3,234,026,242	6,961,068,599
<b>Rezultati neto nga shërbimet e ndërtimit të infrastrukturës së koncesionit (IFRIC 12)</b>			
Shërbime ndërtimi të infrastrukturës së koncesionit		740,973,973	-
Kosto ndërtimi të infrastrukturës së koncesionit		(740,973,973)	-
<b>Rezultati neto nga shërbimet e ndërtimit</b>		-	-
Shpenzime personeli	20	(819,168,470)	(908,966,460)
Shpenzime provigjoni për detyrimet koncesionare	15	-	(98,263,262)
Amortizimi i aktiveve të trupëzuara	6	(146,969,245)	(122,662,739)
Amortizimi i aktiveve të patrupëzuara	7	(492,978,309)	(476,162,897)
Shpenzim për tarifën e koncesionit	16	(124,561,365)	(755,155,565)
Shpenzime të përgjithshme dhe administrative	21	(955,294,844)	(1,326,191,963)
Shpenzime financiare, neto	22	(166,631,151)	(166,140,781)
<b>Fitimi para tatimit</b>		<b>528,422,858</b>	<b>3,107,524,932</b>
Tatimi mbi fitimin	23	(113,218,308)	(590,339,717)
<b>Fitimi neto për vitin</b>		<b>415,204,550</b>	<b>2,517,185,215</b>
<b>Të ardhura të tjera gjithpërfshirëse</b>			
Efekti i diferencave të konvertimit nga përkthimi në monedhën raportuese		99,655,605	(52,288,673)
<b>Totali i të ardhurave gjithpërfshirëse, neto nga taksa</b>		<b>514,860,155</b>	<b>2,464,896,542</b>

Pasqyra e fitimit ose humbjes dhe të ardhurave të tjera gjithpërfshirëse duhet lexuar së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 5 deri në 50, që janë pjesë përbërëse e pasqyrave financiare.

**TIRANA INTERNATIONAL AIRPORT SH.P.K.****PASQYRA E NDRYSHIMEVE NË KAPITAL**  
**Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020**

	<b>Kapitali themeltar</b>	<b>Diferenca konvertimi</b>	<b>Fitime të mbartura</b>	<b>Totali</b>
	<b>në Lek</b>	<b>në Lek</b>	<b>në Lek</b>	<b>në Lek</b>
<b>Gjendja më 1 janar 2019</b>	<b>1,161,148,883</b>	<b>(286,816,216)</b>	<b>3,117,436,922</b>	<b>3,991,769,589</b>
Fitimi neto për vitin	-	-	2,517,185,215	2,517,185,215
Të ardhura të tjera gjithpërfshirëse				
Efekti i diferencave të konvertimit nga përkthimi në monedhën raportuese	-	(52,288,673)	-	52,288,673
<b>Totali i të ardhurave gjithpërfshirëse</b>	<b>-</b>	<b>(52,288,673)</b>	<b>2,517,185,215</b>	<b>2,569,473,888</b>
Shpërndarja e dividendit	-	-	(999,680,000)	(999,680,000)
<b>Gjendja më 31 dhjetor 2019</b>	<b>1,161,148,883</b>	<b>339,104,889</b>	<b>4,634,942,137</b>	<b>5,456,986,131</b>
Fitimi neto për vitin	-	-	415,204,550	415,204,550
Të ardhura të tjera gjithpërfshirëse				
Efekti i diferencave të konvertimit nga përkthimi në monedhën raportuese	-	99,655,605	-	99,655,605
<b>Totali i të ardhurave gjithpërfshirëse</b>	<b>-</b>	<b>(239,449,284)</b>	<b>5,050,146,687</b>	<b>5,971,846,286</b>
Shpërndarja e dividendit (shënimi 18)	-	-	(621,600,000)	(621,600,000)
<b>Gjendja më 31 dhjetor 2020</b>	<b>1,161,148,883</b>	<b>(239,449,284)</b>	<b>4,428,546,687</b>	<b>5,350,246,286</b>

Pasqyra e ndryshimeve në kapital duhet lexuar së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 5 deri në 50, që janë pjesë përbërëse e pasqyrave financiare.

**PASQYRA E FLUKSEVE TË PARASË**  
**Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020**

Shënime	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2020	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2019
	në Lek	në Lek
<b>Flukset e parasë nga veprimtaritë shfrytëzuese</b>	<b>528,422,858</b>	<b>3,107,524,932</b>
<b>Fitimi para tatimit</b>		
<b>Rregullime për:</b>		
Amortizimi	6, 7 639,947,554	598,825,636
Humbje nga nxjerrja jashtë përdorimit e aktiveve	3,811,172	3,910,434
Shpenzime interesi	22 152,318,633	161,292,180
Të ardhura nga interesi	22 (1,259,260)	(3,694,847)
Diferenca nga kursi i këmbimit	22 10,900,355	4,142,402
Provigjoni për llogari të dyshimta	9 134,512,136	307,087,902
Shpenzime provigjoni për detyrimet koncesionare	15 639,947,554	98,263,262
<b>Ndryshimet në kapitalin qarkullues:</b>		
Ndryshimi në llogaritë e arkëtueshme	(63,989,699)	(430,701,648)
Ndryshimi në aktive të tjera	(976,272,252)	(119,990,436)
Ndryshimi në fonde të ngurtësuar në bankë	1,122,719,400	(129,188,400)
Ndryshimi në llogaritë e pagueshme	(28,593,926)	151,714,513
Ndryshimi në tarifën e pagueshme të koncensionit	154,267,331	1,890,310
Ndryshimi në detyrime të tjera	(343,767,739)	(137,110,587)
<b>Flukset neto nga veprimtaritë e shfrytëzimit</b>	<b>1,333,016,563</b>	<b>3,613,965,653</b>
Tatim fitimi i paguar	8 (231,859,645)	(712,139,278)
Interesi i arkëtuar	1,259,215	3,695,232
<b>Flukset e gjeneruara nga veprimtaritë e shfrytëzimit</b>	<b>1,102,416,133</b>	<b>2,905,521,607</b>
<b>Flukset e parasë nga veprimtaritë investuese</b>		
Blerje e aktiveve të patrupëzuara	(11,085,864)	(12,875,717)
Pagesa për punimet në proces	(729,888,109)	(736,149,392)
Blerje e aktiveve të trupëzuara	(87,860,595)	(196,727,338)
<b>Flukset e përdorura për veprimtaritë investuese</b>	<b>(828,834,568)</b>	<b>(945,752,447)</b>
<b>Flukset e parasë nga veprimtaritë financuese</b>		
Pagesa interesi dhe kosto të tjera huamarrjeje	24.5 (1,324,987,531)	(766,870,337)
Shpërndarje dividendi	(30,940,000)	(999,680,000)
<b>Flukset e përdorura në veprimtaritë financuese</b>	<b>(1,355,927,531)</b>	<b>(1,766,550,337)</b>
<b>Ulja e parasë në arkë dhe në bankë</b>	<b>(1,082,345,966)</b>	<b>193,218,823</b>
Paraja në arkë dhe në bankë më 1 janar	11 1,900,846,301	1,714,223,049
Efekti i ndryshimeve të kurseve të këmbimit në paratë në monedhë të huaj	(5,510,088)	(6,595,571)
<b>Paraja në arkë dhe në bankë më 31 dhjetor</b>	<b>11 812,990,247</b>	<b>1,900,846,301</b>

Pasqyra e flukseve të parasë duhet lexuar së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 5 deri në 50, që janë pjesë përbërëse e pasqyrave financiare.



# **TIRANA INTERNATIONAL AIRPORT SH.P.K.**

## **Shënime mbi Pasqyrat Financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020**

*(të gjitha shumat janë të shprehura në Lek, përveçse kur është shprehur ndryshe)*

### **1. SHOQËRIA OPERUESE**

#### **1.1 Informacion i përgjithshëm**

Tirana International Airport Sh.p.k. (“Shoqëria”) u krijua në Shqipëri si një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar më datë 20 shtator 2004. Shoqëria është regjistruar me numër regjistri 32147 në Regjistrin e Shoqërive Tregtare në Gjykatën e Rrethit të Tiranës, Shqipëri. Aktiviteti i saj filloi në vitin 2005.

Në momentin e krijimit, Shoqëria kishte një kapital prej 1,000,000 Lek të ndarë në 1,000 aksione, ku aksionarët e Shoqërisë ishin AviAlliance GmbH (më parë Hochtief Airport GmbH, or “HTA”) dhe Albanian-American Enterprise Fund (ose “AAEF”) përkatësisht me 78.7% dhe 21.3% të totalit të aksioneve. Në tetor të vitit 2004, struktura e aksioneve ndryshoi, me një aksionar të ri, Deutsche Investitions – und Entëicklungsgesellschaft mbH (ose “DEG”), me 31.7% të aksioneve, dhe HTA dhe AAEF me përkatësisht 47.0% dhe 21.3%.

Gjatë vitit 2015, bazuar në ligjin nr. 9901 datë 14 prill 2008 i ndryshuar, Shoqëria bëri nje ristrukturim të kapitalit themeltar duke e ndarë numrin total të aksioneve në 3 (tre) kuota, ku secili nga aksionarët ka kuota si më poshtë:

- a) AviAlliance GmbH ka 1 (nje) kuotë e cila korespondon me 47.0% të totalit të kapitalit dhe është ekuivalente me vlerën 4,406,250 Euro (ekuivalente ne Lek 545,739,975);
- b) DEG ka 1 (nje) kuotë e cila korespondon me 31.7% të totalit të kapitalit dhe është ekuivalente me vlerën 2,971,875 Euro (ekuivalente ne Lek 368,084,196);
- c) AAEF ka 1 (nje) kuotë e cila korespondon me 21.3% të totalit të kapitalit dhe është ekuivalente me vlerën 1,996,875 Euro (ekuivalente ne Lek 247,324,712)

Në mbledhjen e jashtëzakonshme të Asamblesë së aksionarëve të Shoqërisë, të mbajtur më 6 tetor 2016, aksionarët e saj aprovuan njëzëri shitjen dhe transferimin e kuotave te tyre tek askioneri i ri dhe i vetëm Real Fortress Private Limited.

Më tej, në mbledhjen e jashtëzakonshme të Asamblesë së aksionarëve të Shoqërisë të mbajtur në dhjetor 2020, aksionarët e saj aprovuan shitjen dhe transferimin e kuotave të tyre tek aksionari i ri dhe i vetëm Kastrati Group Sh.a.. Sipas Qendres Kombëtare të Biznesit, që prej datës 18 dhjetor 2020, Kastrati Group Sh.a. është aksionari i vetëm i Shoqërisë zotërues i 1 kuote korespondente të 100% të kapitalit ekuivalente me 1,161,148,883 Lek (9,375,000 EUR).

Shoqëria është e vendosur në Aeroportin Ndërkombëtar “Nënë Tereza”, Rinas dhe në datën 31 dhjetor 2020 ka 482 punonjës (31 dhjetor 2019: 563 punonjës).

#### **1.2 Kontrata e Koncesionit**

##### *Përshkrimi i marrëveshjes*

Sipas nenit 9 të Ligjit Shqiptar nr. 7973 “Për Koncesionet dhe Pjesëmarrjen e Sektorit Privat në Shërbimet Publike dhe të Infrastrukturës” datë 26 korrik 1995 (ndryshuar, sipas Ligjit për Koncesionet”), vendimit të Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë “Për Miratimin e Programit dhe Dokumentacionit të Projektit për Zbatimin e Kontratës së Koncesionit për Aeroportin Ndërkombëtar “Nënë Tereza”, Rinas, Tiranë, datë 5 qershor 2003, dhe vendimit të Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë Nr. 48 “Për Përzgjedhjen e Ofertuesit të Preferuar për Realizimin e Kontratës së Koncesionit për Aeroportin Ndërkombëtar “Nënë Tereza”, Rinas, Tiranë”, datë 27 janar 2004 dhe vendimit të Këshillit të Ministrave datë 14 tetor 2004, Qeveria e Shqipërisë, e përfaqësuar nga Ministria e Ekonomisë së Republikës së Shqipërisë dhe Ministria e Transportit dhe Telekomunikacioneve të Republikës së Shqipërisë dhe Shoqëria lidhën Kontratën e Koncesionit të datës 15 tetor 2004 (“Kontrata e Koncesionit”). Kontrata e Koncesionit lidhur midis Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Shoqërisë është ratifikuar nga Parlamenti i Shqipërisë me ligjin nr. 9312 datë 11 nëntor 2004.

Qeveria e Shqipërisë dhe Shoqëria lidhën këtë Kontratë me qëllim që të përcaktojnë termat dhe kushtet për të cilat Shoqëria do të gëzojë të drejtat, *inter alia*:

# **TIRANA INTERNATIONAL AIRPORT SH.P.K.**

## **Shënime mbi Pasqyrat Financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020**

*(të gjitha shumat janë të shprehura në Lek, përveçse kur është shprehur ndryshe)*

### **1. SHOQËRIA OPERUESE (VAZHDIM)**

#### **1.2 Kontrata e Koncesionit (vazhdim)**

*Përshkrimi i marrëveshjes (vazhdim)*

- (i) të hartojë, financojë, ndërtojë, të vërë në punë, të operojë, mirëmbajë, të administrojë dhe zhvillojë Terminalin e ri, Objektet e Reja dhe Objektet e Reja Shtesë në Zonën e Koncesionit;
- (ii) të përdorë dhe rinovojë Terminalin Ekzistues, Vendndodhjen e Terminalit Ekzistues, Aktivet përkatëse dhe Zonën e Koncesionit;
- (iii) të ketë pronësi mbi Objektet e Reja;
- (iv) të gëzojë të drejtën e uzufuktit për një periudhë prej të paktën 20 vjetësh në lidhje me Terminalin Ekzistues, Vendndodhjen e Terminalit Ekzistues, aktivet përkatëse dhe Zonën e Koncesionit; dhe
- (v) të lidhë kontrata për blerjen e çfarëdo lloj aktivesh, të përmbushë detyrimet dhe ushtrrojë të drejtat sipas kësaj Kontrate.

Koncesioni është dhënë për një periudhë 20 vjeçare duke filluar nga data 23 prill 2005 (“Afati i Koncesionit”). Afati i Koncesionit mund të zgjatet:

- (i) ashtu siç është rënë dakort midis palëve (deri në periudhën maksimale ashtu siç parashikohet në Ligj); ose
- (ii) për një periudhë që për arsye madhore mund të shtrihet në dy muaj, në përputhje me pikën 24.5 të Zgjatjes së Afatit të Koncesionit për shkak të Forcave Madhore; ose
- (iii) për kohën e kërkuar për hyrjen në fuqi të Ndryshimit të Pranueshëm.

Më 18 prill 2016, Kuvendi i Republikës së Shqipërisë aprovoi zgjatjen e Kontratës së Koncesionit me 2 vite shtesë, d.m.th. që data e përfundimit shtyhet më 23 prill 2027. Ky vendim u publikua në fletoren zyrtare më 29 qershor 2016 dhe hyri në fuqi më 15 korrik 2016.

Jo më parë se përvjetori i pestë i Datës së Fillimit dhe jo më vonë se 12 muaj përpara përfundimit të Afatit të Koncesionit, secila prej Organizatave Shtetërore të autorizuara dhe Shoqëria mund të fillojë procesin e negociimit lidhur me zgjatjen e periudhës, në formë të shkruar ndaj palës tjetër për të cilën është dhënë fillimisht Koncesioni.

#### *Dorëzimi*

Palët bien dakort që në datën e dorëzimit çdo e drejtë përdorimi, që i është dhënë Shoqërisë në lidhje me Zonën e Koncesionit, pajisjet dhe aktivet ekzistuese, duke përfshirë pa kufizim aktivet e marra në dorëzim, duhet të humbasë fuqinë dhe Shoqëria duhet:

- (i) t’i transferojë Qeverisë së Shqipërisë çdo të drejtë pronësie që ajo ka mbi pajisjet e reja;
- (ii) t’i transferojë Qeverisë së Shqipërisë çdo të drejtë, detyrim dhe përgjegjësi të Shoqërisë lidhur me aktivet në momentin e dorëzimit, Zonën e Koncesionit dhe vetë Koncesionin, përveç dokumentave financiare dhe çdo të drejtë të lidhur me to; dhe
- (iii) t’i dorëzojë Qeverisë së Shqipërisë çdo dokument që ajo zotëron lidhur me çdo artikull të listuar në pikat e mësipërme (i) dhe (ii) si dhe nuk duhet të mbajë asnjë kopje të tyre; në shkëmbim të pagesës, përveçse kur mbaron Afati i Kontratës (dhe jo kur ajo shfuqizohet), nga ana e Qeverisë së Shqipërisë me një shumë të barabartë me vlerën neto të aktiveve (në datën e dorëzimit, në bazë të Parimeve të Përgjithshme Kontabël të Pranuara në Shqipëri) të Shoqërisë (me përjashtim të Fazës A të Terminalit të Ri dhe Fazës A të Produkteve të Reja Kargo), të rregulluara nga një Ekspert Vlerësimi i Pavarur (i cili merr në konsideratë kushtet e aktiveve përkatëse). Të gjitha taksat dhe shpenzimet e lidhura me procesin e transferimit dhe shpërndarjes së aktiveve të përmendura në paragrafet (i) dhe (ii) duhet të mbarten nga Shoqëria. Shoqëria duhet të bashkëpunojë dhe të këshillojë Qeverinë e Shqipërisë dhe çdo Ent Shtetëror si p.sh Organizata Shtetërore e Autorizuar për kërkesa të arsyeshme që ato mund të kenë lidhur me nën-paragrafet (i) dhe (ii) të lart-përmendura.

# **TIRANA INTERNATIONAL AIRPORT SH.P.K.**

## **Shënime mbi Pasqyrat Financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020**

*(të gjitha shumat janë të shprehura në Lek, përveçse kur është shprehur ndryshe)*

### **1. SHOQËRIA OPERUESE (VAZHDIM)**

#### **1.2 Kontrata e Koncesionit (vazhdim)**

*Dorëzimi (vazhdim)*

Të gjitha të drejtat dhe detyrimet e Shoqërisë në momentin e dorëzimit janë të paraqitura në nenin 29 të Kontratës së Koncesionit.

Për më tepër, bazuar në Kontratën e Koncesionit, Shoqëria ka detyrim kontraktual t'i paguajë Qeverisë së Shqipërisë 30% të Fitimit të Shpërndashëm referuar si "Kuota Junior", përveç rasteve kur pagesa e një shume të tillë është e kufizuar nga Dokumentat e Financimit me Huadhënësit Kryesorë ose Huadhënësit e Nënrenditur (referencë Neni 20c dhe Shtojca 43 e Kontratës së Koncesionit).

*Të drejtat e Shoqërisë*

Shoqëria duhet të ketë të drejtë, përveç të drejtave të garantuara në Kontratën e Koncesionit:

- (i) të punësojë apo angazhojë Persona që Shoqëria i cilëson si të domosdoshëm për të dhënë konsulencë;
- (ii) të përcaktojë politikën e saj të punësimit në përputhje me ligjin në fuqi;
- (iii) të ndërmarë veprime të tjera të konsideruara si të domosdoshme prej saj për të realizuar me sukses Projektin, përmbushur detyrimet e saj dhe të ushtrojë të drejtat e saj që rrjedhin nga Kontrata;
- (iv) të zgjasë afatin aq sa do të zgjasë edhe vonesa në shpronësimin e pronës private të paluajtshme në Zonën e Koncesionit dhe Shpronësimi i Kërkuar i Tokës dhe shkarkohet nga pagesat e sanksioneve;
- (v) të ruajë, ashtu siç parashikohet në Kontratë, të sigurojë të mirat dhe shërbimet nga çdo burim nëpërmjet negociatave direkte në bazë të kontratave të parashikuara në ligjet në fuqi;
- (vi) të optimizojë strukturën e financimit të Shoqërisë gjatë Afatit të Koncesionit;
- (vii) të ndryshojë, nëse e gjykon të përshtatshme, strukturën e Aksionarëve;
- (viii) t'i zgjatet afati për aq kohë sa do të zgjasë edhe çdo afat vonesa e shkaktuar nga zbulime arkeologjike dhe / ose hetime të kërkuara nga Qeveria e Shqipërisë ose Ent Shtetëror në Zonën e Koncesionit, që mund të çënojë përmbushjen nga Shoqëria të secilit prej Detyrimeve Bazë dhe Detyrimeve Shtesë, përfshi edhe shkarkimin nga përgjegjësia për pagesat e sanksioneve (për mospërmbushje të detyrimeve bazë ose detyrimeve shtesë) të shkaktuara nga zbulime dhe kërkime të tilla;
- (ix) shtyrjen e një Date të Kryerjes së një detyrimi të parashikuar në Detyrimet Bazë apo Shtesë, e cila vjen si pasojë e një Ndryshimi të mundshëm; dhe
- (x) të bëjë një ofertë publike fillestare të pjesëve të zakonshme të kapitalit deri në një maksimum prej 49% në çdo kohë gjatë Afatit të Koncesionit dhe në përputhje me Ligjet në fuqi me disa kushte siç është përcaktuar në Kontratë.

### **2. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE BAZË KONTABËL**

#### **2.1 Baza e përputhshmërisë**

Këto pasqyra financiare janë përgatitur në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar ("SNRF"), përfshirë dhe metodën e konvertimit të përcaktuar në SNA 21.39 dhe SNA 21.42 për pasqyrat financiare që prezantohen në një monedhë të ndryshme nga ajo funksionale.

#### **2.2 Baza e përgatitjes**

Pasqyrat financiare janë përgatitur bazuar në koston historike. Politikat kryesore kontabël paraqiten më poshtë.

## TIRANA INTERNATIONAL AIRPORT SH.P.K.

### Shënime mbi Pasqyrat Financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020

(të gjitha shumat janë të shprehura në Lek, përveçse kur është shprehur ndryshe)

## 2. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE BAZË KONTABËL (VAZHDIM)

### *Parimi i vijueshmërisë së veprimtarisë*

Në mars 2020 në botë dhe në Shqipëri u shpall gjendja e pandemisë. Shumë shtete kanë vendosur kufizime të lëvizjes së lirë për miliona njerëz dhe për rrjedhojë shumë njerëz nga vendodhje të ndryshme janë subjekt i masave të karantinimit. Kjo situatë ka ndikuar edhe në aktivitetin e Shoqërisë. Aktualisht, shumë vende, përfshi këtu edhe Shqipërinë, kanë filluar të lehtësojnë masat e shtrëngimit dhe procesi i vaksinimit masiv ka filluar tashmë. Si rrjedhojë, edhe Shoqëria pret që këto masa të kenë një efekt pozitiv në funksionimin e saj operacional. Përpos kësaj, Tirana International Airport është aeroporti i vetëm funksional në Shqipëri dhe kjo shton mundësitë e saj për të rekuperuar efektet negative të pandemisë.

Tabela e mëposhtme përfaqëson të ardhurat tremujore të Shoqërisë. Ndikimi më i rëndësishëm ka qenë nga masat e vendosura për mbylljen e plotë në Mars 2020 menjëherë pas përhapjes të pandemisë. Të ardhurat janë rekuperuar ndjeshëm në tremujorët pasues dhe megjithëse mund të duhet ca kohë për t'iu rikthyer niveleve para pandemisë, të ardhurat në mënyrë të mjaftueshme mbulojnë nevojat për fonde dhe investime të Shoqërisë.

	Q1	Q2	Q3	Q4
2020	1,207,520,153	126,908,951	1,207,404,903	692,192,235
2019	1,381,453,050	1,684,542,282	2,262,016,530	1,633,056,737

Për më tepër, Shoqëria ka marrë masa për të përballuar efektet e aktivitetit të reduktuar të tilla si mbajtjen në një nivel të domosdoshëm të shpenzimeve duke mos kompromentuar sigurinë dhe sigurinë teknike. Gjatë vitit 2020, Shoqëria pagoi të gjithë detyrimin e mbetur të kredive të marra, duke lënë likuiditet të vlefshëm vetëm për nevojat operacionale. Shoqëria pret të ketë një rritje të trafikut gjatë vitit 2021 dhe do të jetë në gjendje të mbulojë shpenzimet e saj operacionale me të ardhurat e parashikuara dhe pret të jetë fitimprurëse gjatë vitit financiar 2021.

Shoqëria është aeroporti i vetëm operacional në Shqipëri dhe për rrjedhojë nuk mban riskqe për vazhdueshmërinë e tij. Për më tepër, TIA kërkohet të jetë operacionale gjatë gjithë kohës. Kështu që, pasqyrat financiare vijnë të përgatiten duke mbajtur parasysh parimin e vijueshmërisë.

### 2.3 Monedha funksionale dhe raportuese

Pasqyrat financiare janë përgatitur në Euro, që është monedha primare në mjedisin ekonomik në të cilin Shoqëria operon (monedha funksionale e saj). Për qëllim të raportimit vendas, këto pasqyra financiare janë paraqitur në Lek, që është monedha raportuese për qëllime të raportimit vendas.

Rezultati dhe pozicioni financiar i Shoqërisë konvertohen në monedhën raportuese duke konvertuar (i) aktivet dhe detyrimet me kursin e datës së raportimit; dhe (ii) të ardhurat dhe shpenzimet me kursin në datën e transaksionit (iii) kapitali aksionar me kursin historik. Të gjitha diferencat që rezultojnë nga këmbimi në monedhën raportuese njihen në pasqyrën e fitimit ose humbjes dhe të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse.

## TIRANA INTERNATIONAL AIRPORT SH.P.K.

### Shënime mbi Pasqyrat Financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020

(të gjitha shumat janë të shprehura në Lek, përveçse kur është shprehur ndryshe)

## 2. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE BAZË KONTABËL (VAZHDIM)

### 2.4 Transaksionet në monedha të huaja

Diferencat që rezultojnë nga konvertimi i zërave monetarë në monedhë të huaj me kurs të ndryshëm nga ato që janë konvertuar në njohjen fillestare gjatë periudhës ose në pasqyra të mëparshme financiare, njihen në pasqyrën e fitimit ose humbjes dhe të ardhurave të tjera gjithpërfshirëse, në periudhën që ato krijohen. Kurset e mëposhtme janë aplikuar gjatë vitit:

	Kursi mesatar		Kursi në datën e raportimit	
	2020	2019	2020	2019
Lek / USD	108.53	109.85	100.84	108.64
Lek / EUR	123.77	123.00	123.70	121.77

### 2.5 Instrumentat financiarë

Një instrument financiar është cdo kontratë që sjell një aktiv financiar për një shoqëri dhe një detyrim financiar ose instrumenta të kapitalit për një shoqëri tjetër. Instrumentat financiarë jo-derivativë të Shoqërisë, përfshijnë llogari të arkëtueshme, para dhe ekuivalente me të, llogari të pagueshme dhe kredi bankare dhe hua të tjera. Gjatë periudhave të raportimit nuk ka investime në letra me vlerë të kapitalit apo instrumenta borxhi në vazhdimësi të aktivitetit.

#### i) Aktivët financiarë

##### Njohja fillestare dhe matja

Aktivët financiarë klasifikohen, në njohjen fillestare, dhe më pas maten me koston e amortizuar, me vlerën e drejtë nëpërmjet pasqyrës së fitimit ose humbjes dhe të të ardhurave të tjera gjithpërfshirëse dhe me vlerën e drejtë nëpërmjet pasqyrës së fitimit ose humbjes.

Klasifikimi i aktiveve financiare në njohjen fillestare varet nga vetitë kontraktuale të fluksit të parasë të aktivitetit financiar dhe modelit financiar të TIA-s për manaxhimin e tyre. Llogaritë e arkëtueshme, të cilat nuk përmbajnë një element financimi të rëndësishëm ose ato për të cilat Shoqëria ka zbatuar metodën praktike, maten me cmimin e transaksionit sic përcaktohet në SNRF 15. Referencë në politikat kontabile në seksionin (e) *Të Ardhurat nga Kontratat me Konsumatorët*.

Në mënyrë që një aktiv financiar të klasifikohet dhe të matet me koston e amortizuar ose me vlerën e drejtë nëpërmjet pasqyrës së fitimit ose humbjes dhe të të ardhurave të tjera gjithpërfshirëse, është e nevojshme të sjellë flukse të parasë të cilat janë “vetëm pagesa të principalit dhe interesit (VPPI)” mbi principalin e mbetur. Ky vlerësim njihet si testi VPPI dhe aplikohet në nivel instrumenti.

Modeli i biznesit të TIA-s për manaxhimin e aktiveve financiare tregon se si Shoqëria manaxhon aktivët e saj financiare në mënyrë që të sigurojë fluse të parasë. Modeli i biznesit përcakton nëse flukset e parasë sigurohen si rezultat i arkëtimit të flukseve të parasë si rrjedhojë e kontratave, shitjes së aktiveve financiare ose si rrjedhojë e të dyjave së bashku.

##### Matja e mëtejshme

Për qëllime të matjes së mëtejshme, aktivët financiarë, klasifikohen në katër kategori:

- Aktive financiare me kosto të amortizuar (instrumentat e borxhit)
- Aktive financiare me vlerën e drejtë nëpërmjet pasqyrës së fitimit ose humbjes dhe të të ardhurave të tjera gjithpërfshirëse me qarkullim të fitimeve dhe humbjeve kumulative (instrumentat e borxhit)
- Aktive financiare me vlerën e drejtë nëpërmjet pasqyrës së fitimit ose humbjes dhe të të ardhurave të tjera gjithpërfshirëse pa qarkullim të fitimeve dhe humbjeve kumulative në momentin e heqjes nga librat kontabël (equity instruments)
- Aktivët financiarë me vlerë të drejtë nëpërmjet pasqyrës së fitimit ose humbjes

TIA ka aktive financiare vetëm të kategorisë së parë, e cila përshkruhet më me detaje më poshtë.

## **2. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE BAZË KONTABËL (VAZHDIM)**

### **2.5 Instrumentat financiarë (vazhdim)**

#### *i) Aktivet financiare (vazhdim)*

##### **Aktive financiare me kosto të amortizuara (instrumentat e borxhit)**

Kjo kategori është e vetmja e aplikueshme për TIA-n. Shoqëria mat aktivet financiare me koston e amortizuar, nëse të dyja kushtet e mëposhtme plotësohen:

- Aktiv financiar mbahet sipas një modeli financiar me objektivin për të mbajtur aktive financiare me qëllim bledhjen e flukseve të parasë të kontraktuara.
- Termat kontraktuale të aktivitetit financiar parashtrajnë data specifike për flukset e parasë të cilat janë të lidhura vetëm me pagesa të principalit dhe interesit mbi principalin e mbetur.

Aktivitetet financiare me kosto të amortizuara më tej maten duke përdorur metodën e interesit efektiv dhe janë subjekt i zhvlerësimit. Fitimet dhe humbjet njihen në pasqyren e fitimit ose humbjes në momentin kur aktivi hiqet nga librat kontabël, modifikohet ose zhvlerësohet.

Aktivitetet financiare të TIA-s me koston e amortizuar përfshijnë llogaritë e arkëtueshme, paranë në arkë dhe në bankë dhe depozita afatshkurtra.

*Paraja në arkë dhe në bankë* përfshin paranë në arkë dhe depozitat afatshkurtra. Paradhëniet bankare të cilat janë të pagueshme menjëherë (nëse ka të tilla) dhe janë pjesë integrale e manaxhimit të parasë së Shoqërisë, janë të përfshira si pjesë e parasë në arkë dhe në bankë për qëllime të pasqyrës së fluksit të parasë.

Kontabilizimi i të ardhurave dhe shpenzimeve financiare diskutohet në notën 2.15.

#### **Heqja nga librat kontabël**

Një aktiv financiar (ose, kur është e aplikueshme, pjesë e një aktiviteti financiar ose e një grupi me aktive financiare të ngjashme) hiqet nga librat kontabël (dmth hiqet nga pasqyra e pozicionit financiar të Shoqërisë), kur:

- Të drejtat për të marrë fluksë paraje nga aktivi kanë skaduar ose
- Shoqëria ka transferuar të drejtat e saj për të marrë flukse të parasë nga aktivi ose ka parashikuar një detyrim për të paguar flukset e parave të marra totalisht pa vonesa të rëndësishme kundrejt palëve të treta nën një marrëveshje të garantuar; dhe ose (a) Shoqëria ka transferuar të gjitha risqet dhe përfitimet kryesore të aktivitetit, ose (b) Shoqëria as nuk ka transferuar dhe as nuk mban risqet dhe përfitimet kryesore të aktivitetit, por ka transferuar kontrollin mbi aktivin.

Kur Shoqëria ka transferuar të drejtat e saj për të marrë flukset e parasë nga një aktiv ose ka hyrë në një marrëveshje të garantuar, ajo vlerëson nëse dhe në çfarë mase, ajo ka mbajtur risqet dhe përfitimet e pronësisë. Në rastet kur ajo nuk ka transferuar dhe as ka mbajtur në mënyrë thelbësore risqet dhe përfitimet e aktivitetit, si dhe nuk ka transferuar kontrollin mbi aktivin, Shoqëria vazhdon të njohë aktivin e transferuar për aq kohë sa ajo vazhdon të jetë e përfshirë. Në këtë rast, Shoqëria njihet gjithashtu një detyrim të lidhur. Aktivi i transferuar dhe detyrimi i lidhur me të, maten duke reflektuar të drejtat dhe detyrimet që Shoqëria ka mbajtur.

## **2. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE BAZË KONTABËL (VAZHDIM)**

### **2.5 Instrumentat financiarë (vazhdim)**

#### *i) Aktivet financiare (vazhdim)*

##### **Zhvlerësimi i aktiveve financiare**

Shënime shpjeguese të mëtejshme lidhur me zhvlerësimin e aktiveve financiare, janë parashtruar në shënimet shpjeguese si më poshtë:

- Shënime shpjeguese për supozime të rëndësishme shënimi 3
- Llogari të arkëtueshme shënimi 9

Shoqëria njih një fond për humbjet e pritshme për të gjitha instrumentat e borxhit të cilat nuk mbahen me vlerën e drejtë përmes pasqyrës së fitimit ose humbjes. Humbjet e pritshme përlllogariten si diferencë midis flukseve kontraktuale të parasë të pritshme sipas kontratës me flukset e parasë që Shoqëria pret të marrë të diskontuara këto për afërsisht me normën efektive fillestare të interesit. Flukset e pritshme të parasë do të përfshijnë flukset e parasë nga shitja e kolateralit të mbajtur ose nga flukset e parasë të metodave të tjera të uljes së riskut, të cilat janë pjesë përbërëse e kushteve kontraktuale.

#### *i) Aktivet financiare (vazhdim)*

Shoqëria merr parasysh humbjet e mëparshme të rishikuara me faktorët e mundshëm të të ardhmes. Gjithashtu, Shoqëria analizon informacionet të posaçme për klientët e saj kryesor, kompanitë ajrore, duke përfshirë vlerësimin e aftësive paguese, historikun e pagesave dhe paradhëniet në formën e garancive. Kryesisht përlllogaritja e humbjeve të pritshme bëhet duke marrë në analizë klientët individualë, duke përdorur metodën e aktualizimit të flukseve të pritshme të parasë.

Shoqëria e quan një aktiv financiar në vështirësi për t'u arkëtuar në rastet kur pagesat kontraktuale janë 90 ditë me vonesë. Megjithatë, në disa raste, Shoqëria mundet gjithashtu që ta konsiderojë një aktiv financiar në vonesë pagese, atëherë kur informacioni i brendshëm ose i jashtëm tregon që Shoqëria ka pak mundësi të arkëtojë të plota shumat e mbetura kontraktuale para se të konsiderojë metodat e uljes së riskut të kredisë. Një aktiv financiar hiqet nga librat kontabël kur nuk ka asnjë tregues të arsyeshëm që flukset kontraktuale të parasë do të arkëtohen.

#### *ii) Detyrimet financiare*

##### **Njohja fillestare dhe matja**

Detyrimet financiare, në njohjen fillestare, klasifikohen si: detyrime financiare nëpërmjet pasqyrës së fitimeve dhe humbjeve, kredi dhe borxhe, llogari të pagueshme, ose si derivate të destinuara si instrumenta mbrojtës në një mbrojtje efektive, sipas përkatësisë. Të gjitha detyrimet financiare njihen fillimisht me vlerën e drejtë dhe, në rastin e kredive dhe borxheve dhe llogarive të pagueshme, njihen neto me kostot direkte të transaksionit. Detyrimet financiare të TIA-s përfshijnë llogaritë e pagueshme dhe kreditë bankare dhe hua të tjera.

##### **Matja e mëtejshme**

Matja e detyrimeve financiare varet nga klasifikimi i tyre, sic përshkruhet më poshtë:

- Detyrime financiare të matura me vlerën e drejtë nëpërmjet pasqyrës së fitimeve dhe humbjeve
- Kredi dhe borxhe

TIA nuk ka detyrime financiare të matura me vlerën e drejtë nëpërmjet pasqyrës së fitimeve dhe humbjeve, dhe më poshtë paraqitet një përmbledhje e kredive dhe borxheve.

## **2. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE BAZË KONTABËL (VAZHDIM)**

### **2.5 Instrumentat financiarë (vazhdim)**

#### *ii) Detyrimet financiare (vazhdim)*

##### **Kreditë dhe borxhet**

Kjo është kategoria më materiale për TIA-n. Pas njohjes fillestare, kreditë dhe borxhet maten më tej me koston e amortizuar duke përdorur metodën e interesit efektiv. Fitimet dhe humbjet njihen në pasqyrën e fitimeve dhe humjeve në momentin kur detyrimet hiqen nga librat kontabël si dhe nëpërmjet procesit të amortizimit me interesin efektiv. Kostoja e amortizuar llogaritet duke marrë në konsideratë çdo ulje të përfituar në blerje si dhe tarifata ose kostot që janë pjesë përbërëse e normës efektive të interesit. Amortizimi me normën efektive të interesit njihet si kosto financiare në pasqyrën e fitimeve dhe të humbjeve. Për më shumë informacion, referohuni në Shënimin 12.

##### **Heqja nga librat kontabël**

Një detyrim financiar hiqet nga librat kontabël kur detyrimi shlyhet, anulohet ose shuhet. Kur një detyrim financiar ekzistues zëvendësohet nga një tjetër detyrim i marrë nga i njëjti kredi-dhënës me kushte rrënjësisht të ndryshme, ose kur kushtet e një detyrimi ekzistues ndryshohen rrënjësisht, ky shkëmbim ose ndryshim trajtohet si heqje nga librat kontabël e detyrimit ekzistues dhe njohje e një detyrimi të ri. Diferenca në balancat e mbetura njihet në pasqyrën e fitimeve dhe humbjeve.

#### *iii) Kompensimi i instrumentave financiarë*

Aktivitetet financiare dhe detyrimet financiare netohen dhe vlera neto njihet në pasqyrën e pozicionit financiar nëse ekziston një e drejtë ligjore e ekzekutueshme për të netuar shumat e njohura dhe ka një qëllim për shlyerje mbi balancën neto për të përfituar aktivin dhe për të shlyer detyrimin njëkohësisht.

### **2.6 Aktivitetet e trupëzuara**

#### *(i) Njohja dhe matja*

Aktivitetet e trupëzuara paraqiten me koston minus zhvlerësimin e akumuluar dhe humbjet nga rënia në vlerë, nëse ka. Kosto përfshin shpenzime që lidhen drejtpërdrejt me blerjen e aktivitetit. Kosto e aktiveve të ndërtuara nga vetë Shoqëria përfshin koston e materialeve dhe të fuqisë punëtore (nëse ka), si dhe ndonjë kosto tjetër që lidhet drejtpërdrejt me vënien e aktivitetit në vendin dhe kushtet e nevojshme që ai të jetë i përdorshëm në mënyrën e synuar, si dhe kostot e çmontimit, largimit dhe restaurimit të vendit ku janë vendosur.

Programet kompjuterike të blera, të cilat janë pjesë përbërëse e funksionimit të pajisjes përkatëse, kapitalizohen si pjesë e saj. Kur pjesë të një elementi të aktiveve të trupëzuara kanë jetëgjatësi të ndryshme, ato kontabilizohen si elemente të veçanta të aktiveve të trupëzuara.

Të ardhurat dhe humbjet nga shitja e një aktivi të trupëzuar përcaktohen duke krahasuar të hyrat nga shitja e aktivitetit me vlerën kontabël të tij dhe njihen me vlerë neto tek “të ardhura të tjera”/” shpenzime të përgjithshme dhe administrative” në pasqyrën e fitimit ose humbjes dhe të ardhurave të tjera gjithpërfshirëse (në fitim ose humbje).

#### *(ii) Kostot e metejshme*

Nëse është e mundur që përfitime ekonomike që i atribuohen një elementi të aktiveve të trupëzuara do të rrjedhin në të ardhmen në Shoqëri dhe kostoja e tij mund të matet në mënyrë të besueshme, kostoja e zëvendësimit të një pjese të një elementi të aktiveve të trupëzuara njihet me vlerën kontabël të elementit. Vlera e mbetur e aktiveve të zëvendësuar çregjistrohet. Kostot e shërbimeve ditore të aktiveve të trupëzuara njihen në pasqyrën e fitimit ose humbjes dhe të ardhurave të tjera gjithpërfshirëse (fitim ose humbje) në momentin kur ato ndodhin.



## TIRANA INTERNATIONAL AIRPORT SH.P.K.

### Shënime mbi Pasqyrat Financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020

(të gjitha shumat janë të shprehura në Lek, përveçse kur është shprehur ndryshe)

## 2. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE BAZË KONTABËL (VAZHDIM)

### 2.6 Aktivet e trupëzuara (vazhdim)

#### (iii) Amortizimi

Zhvlerësimi njihet në pasqyrën e fitimit ose humbjes dhe të ardhurave të tjera gjithpërfshirëse (fitim ose humbje) dhe llogaritet me metodën lineare sipas jetëgjatësisë së çdo pjese apo njësie të aktiveve të trupëzuara. Aktivet e marra me qira zhvlerësohen sipas më të voglës midis jetëgjatësisë së aktivitetit dhe kohës së huasë, përveçse kur që është e qartë se Shoqëria do të fitojë pronësinë në përfundim të kontratës së qirasë. Toka nuk zhvlerësohet.

Normat e zhvlerësimit për periudhën aktuale dhe periudhën krahasuese janë si më poshtë:

	Në %
• Përmirësimet e ndërtesave ekzistuese	periudha e koncesionit
• Makineri dhe pajisje	20
• Pajisje kompjuterike, mobilje dhe orendi	25
• Automjete	20

Metodat e amortizimit, jetëgjatësia dhe vlera e mbetur e aktiveve të trupëzuara rishikohen në çdo datë raportimi.

### 2.7 Aktivet e patrupëzuara

#### (i) Marrëveshja e shërbimit koncesionar

Shoqëria njih një aktiv të patrupëzuar që rrjedh nga kontrata e shërbimit të koncesionit kur ka të drejtë të faturojë përdoruesit e infrastrukturës koncesionare. Aktivet e patrupëzuara njihen fillimisht me kosto, që është vlera e drejtë e pagesës për të drejtën për të ofruar shërbime aeroportuale sic përcaktohet në marrëveshjen e koncesionit. Pas njohjes fillestare, aktivi i patrupëzuar matet me kosto minus amortizimin e akumuluar dhe humbjet e akumuluar nga rënia në vlerë, nëse ka.

Shoqëria ka aplikuar standardin KIRFN 12 *Marrëveshje të shërbimit koncesionar*, efektiv për periudhën më ose pas 1 janar 2008. Meqenëse interpretimi e lejon aplikimin para hyrjes në fuqi, ai është aplikuar në përgatitjen e pasqyrave financiare të 31 dhjetorit 2008. Në bazë të KIRFN 12 *Marrëveshje të shërbimit koncesionar*, aktivet e patrupëzuara përfaqësojnë të drejtën e Shoqërisë për të përfituar shërbime koncesionare kundrejt pagesave me ose pa para në dorë dhe transferuar Qeverisë së Shqipërisë. Në bazë të Kontratës së Koncesionit midis Shoqërisë dhe Qeverisë së Shqipërisë, aktivet e patrupëzuara përfshijnë tre komponentët në vazhdim të mjeteve monetare dhe ekuivalentëve me to dhe të drejtave jo monetare të dhëna në këmbim të shërbimit koncesionar të përfituar:

#### 1) Pagesa në mjete monetare: Komision i marrjes së koncesionit (Kontrata e Koncesionit, Seksioni 3 “Kushtet Paraprake”)

Komisioni i marrjes së koncesionit përfaqëson komisionin e paguar nga Shoqëria ndaj Qeverisë së Shqipërisë, kundrejt përfitimit të shërbimeve koncesionare. Ky element i aktiveve të patrupëzuara regjistrohet me kosto, që është vlera e shumës së paguar.

#### 2) Ekuivalentë me mjete monetare: Huaja e Qeverisë (Kontrata e Koncesionit, Seksioni 4)

Në rastin kur e drejta për të përfituar shërbime koncesionare është përfituar në këmbim të ripagimit të shumës së huasë së mëparshme, e cila përfaqëson një detyrim afatgjatë të Qeverisë, shlyerja e detyrimit është bërë nëpërmjet disa pagesave të shtyra në kohë. Kosto e këtij komponenti është vlera e drejtë e përfitimit prej tij, e cila është njohur si vlera aktuale e pagesave të shtyra në kohë, të skontuara me një normë interesi të caktuar. Ky interes është ajo normë, e cila skonton vlerën nominale të transaksionit kundrejt çmimit aktual ekuivalent në mjete monetare (shiko shënimin 17 (b)).

## **2. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE BAZË KONTABËL (VAZHDIM)**

### **2.8 Aktivet e patrupëzuara (continued)**

(i) *Marrëveshja e shërbimit koncesionar (continued)*

#### **3) Konsiderime jo në mjete monetare: Punime ndërtimi (Kontrata e Koncesionit, Seksioni 19-32)**

E drejta për të përfituar shërbime koncesionare në këmbim të punimeve ndërtimore në ndërtesat e ambienteve të reja të aeroportit (Seksioni 19-32 i Kontratës së Koncesionit), njihet me vlerën e kostos së ndërtimit, e cila konsiderohet të jetë vlera e tij e drejtë. Punimet ndërtimore janë një detyrim kontraktual bazuar në Kontratën e Koncesionit të cilën kompania e përmbush duke kontraktuar shërbime të mirëmbajtjes dhe të ndërtimit.

(ii) *Aktive të tjera të patrupëzuara*

Aktivet e tjera të patrupëzuara të blera nga Shoqëria, të cilat kanë jetëgjatësi të përcaktuar, paraqiten me kosto minus amortizimin e akumuluar dhe humbjet nga rënia në vlerë.

(iii) *Shpenzimet e mëtejshme*

Kostot e mëtejshme të aktiveve të patrupëzuara kapitalizohen vetëm nëse rrisin përfitimet ekonomike në të ardhmen, që i atribuohen atij aktivi specifik. Të gjitha kostot e tjera njihen në pasqyrën e fitimit ose humbjes dhe të ardhurave të tjera gjithpërfshirëse (fitim ose humbje) në momentin kur ato ndodhin.

(iv) *Amortizimi*

Jeta ekonomike e një aktivi të patrupëzuar në një kontratë koncesioni është periudha kur ai është i vlefshëm për t'u përdorur deri në përfundim të periudhës së koncesionit. Amortizimi është njohur në pasqyrën e fitimit ose humbjes dhe të ardhurave të tjera gjithpërfshirëse (fitim ose humbje) në mënyrë lineare përgjatë jetëgjatësisë së parashikuar të çdo pjese të asetit. Metodot e amortizimit, jetëgjatësia dhe vlera e mbetur e aktiveve të trupëzuara rishikohen në çdo datë raportimi.

Normat e amortizimit për periudhën aktuale dhe periudhën krahasuese janë si më poshtë::

	<b>Baza e amortizimit</b>
• <i>Pagesa koncesionare</i>	<i>periudha e koncesionit</i>
• <i>Kredia e mëparshme</i>	<i>periudha e koncesionit</i>
• <i>Terminali i ri i pasagjerëve dhe kargos dhe terminali ekzistues</i>	<i>periudha e koncesionit</i>
• <i>Aktive të tjera të patrupëzuara</i>	<i>periudha e koncesionit</i>

Në prill 2016, Qeveria e Shqipërisë dhe Shoqëria firmosën marrëveshjen për shtyrtjen e periudhës së koncesionit dhe heqjen e të drejtave ekskluzive për fluturimet ndërkombëtare. Aprovimi i zgjatjes së jetës së koncesionit u bë efektive më 15 korrik 2016.

Pas zgjatjes së periudhës së koncesionit për dy vjet, Kompania ka rivlerësuar jetën e dobishme të aktiveve që i përkasin kësaj kategorie.

Vlera e mbetur dhe jetëgjatësia e një asemi do të rishikohet të paktën në fund të çdo viti financiar dhe, nëse pritshmëritë ndryshojnë nga vlerësimi i mëparshëm, ndryshimi do të trajtohet si një ndryshim në vlerësimin kontabël sipas SNK 8 Politikat Kontabël, Ndryshimet në Vlerësimet Kontabël dhe Gabimet. Ndryshimet e pritshme në jetën e një asemi të amortizueshëm, që nënkupton jetëgjatësinë e vlerësuar, do të ndikojnë në shpenzimet e amortizimit në periudhën kur ndodh ndryshimi në vlerësim, dhe në të gjitha periudhat e ardhshme për jetëgjatësinë e mbetur të asetit. Efekti i ndryshimit në vlerësimin kontabël është njohur prospektivisht duke e përfshirë atë në fitimin ose humbjen në periudhën e ndryshimit dhe periudhat e ardhshme, nëse ndryshimi ndikon edhe njëherë dhe të tjerat. Për nga natyra, rishikimi i një vlerësimi nuk lidhet me periudhat e më parëshme dhe nuk është një rregullim gabimi.

Bazuar në arsyetimin e mësipërm, Shoqëria do të mund të gjenerojë përfitime ekonomike për 2 vite shtesë. Githashtu, duke filluar nga data 1 gusht 2016, Shoqëria amortizoi listën e sipërpërmendur të aseteve bazuar në jetën e zgjatur të koncesionit.

## **TIRANA INTERNATIONAL AIRPORT SH.P.K.**

### **Shënime mbi Pasqyrat Financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020**

*(të gjitha shumat janë të shprehura në Lek, përveçse kur është shprehur ndryshe)*

## **2. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE BAZË KONTABËL (VAZHDIM)**

### **2.9 Inventarët**

Inventarët mbahen me vlerën më të vogël midis kostos dhe vlerës neto të realizueshme. Kosto e inventarëve bazohen në metodën “hyrja e parë, dalja e parë” dhe përfshin shpenzimet që ndodhin në blerjen e tyre, prodhimin ose këmbimin dhe kosto të tjera për t’i sjellë ato në kushtet dhe vendndodhjen ekzistuese. Kosto përfshin edhe një pjesë të përshtatshme të kostove operacionale bazuar në kapacitetin normal operacional.

Vlera neto e realizueshme është çmimi i parashikuar i shitjes në aktivitetin normal të biznesit duke hequr kostot e përfundimit dhe shpenzimet e shitjes.

### **2.10 Paraja dhe depozitat afat-shkurtra**

Paraja dhe depozitat afat-shkurtra në pasqyrën e pozicionit fillestar përmbajnë paranë në bankë dhe në arkë dhe depozitat afat-shkurtra me një afat maturimi prej tre muajsh ose më pak, të cilat janë subjekt i një risku të ulët të ndryshimit në vlerë.

Për qëllimet e pasqyrës së flukseve të parasë, paraja në arkë dhe në bankë përbëhet nga paraja në arkë dhe depozitat afat-shkurtra, sic është përcaktuar më përpara, neto me paradhëniet afat-shkurtra bankare (nëse ka të tilla) duke u konsideruar si pjesë përbërëse e manaxhimit të parasë të TIA-s.

### **2.11 Rënia në vlerë e aktiveve jo-financiare**

Shënime shpjeguese të mëtejshme lidhur me rënien në vlerë të aktiveve jo-financiare referohen edhe në shënimin më poshtë:

- Aktive të trupëzuara Shënimi 6
- Aktive të patrupëzuara, neto dhe punime në proces Shënimi 7

Në çdo datë raportimi Shoqëria vlerëson nëse ka tregues që një aktiv mund të zhvlerësohet. Nëse ekziston ndonjë tregues, ose kur kërkohet prova vjetore për matjen e zhvlerësimit, Shoqëria vlerëson vlerën e rikuperueshme të aktivitetit, me qëllim përcaktimin e masës së humbjes (nëse ka të tillë).

Vlera e rikuperueshme e një aktivi ose njësisë gjeneruese të parasë është vlera më e madhe midis vlerës në përdorim dhe vlerës së drejtë minus koston e shitjes. Për përcaktimin e vlerës në përdorim, skontohej rrjedhat e ardhshme të parasë duke përdorur normën e skontimit para tatimit, e cila reflekton vlerësimet aktuale të tregut të vlerës në kohë të parasë dhe rreziqeve specifike të aktivitetit. Për të përcaktuar vlerën e drejtë minus koston e nxjerrjes jashtë përdorimit, merren parasysh transaksionet e tregut të kryera së fundmi. Nëse transaksione të tilla nuk mund të gjenden, përdoret një model i përshtatshëm vlerësimi. Për qëllime të testimit të rënies në vlerë, aktivet grupohen së bashku në grupin më të vogël të tyre i cili gjeneron rrjedha parash nga përdorimi i vazhdueshëm i tyre dhe që janë të pavarura nga rrjedhat e parasë të aktiveve ose grupeve të tjera të aktiveve (“njësia gjeneruese e parasë”).

Një humbje nga rënia në vlerë njihet nëse vlera e mbetur e një aktivi apo e njësisë së tij gjeneruese të parasë tejkalon vlerën e rikuperueshme. Humbjet nga rënia në vlerë njihen në pasqyrën e fitimit ose humbjes dhe të ardhurave të tjera gjithpërfshirëse.

Humbjet nga rënia në vlerë, që janë njohur në periudhat e mëparshme, vlerësohen në çdo datë raportimi nëse ka evidencë që humbja është ulur ose nuk ekziston më. Humbja nga rënia në vlerë çregjistrohet nëse ka patur ndryshime në përcaktimin e vlerës së rikuperueshme. Humbja nga rënia në vlerë çregjistrohet në masën që vlera kontabël e aktivitetit nuk tejkalon vlerën e tij kontabël neto nga zhvlerësimi ose amortizimi që do të ishte përcaktuar, nëse nuk do të ishte njohur humbje nga rënia në vlerë.

## **2. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE BAZË KONTABËL (VAZHDIM)**

### **2.12 Përfitimet e punonjësve**

Shoqëria, në rrjedhën normale të aktivitetit të saj, kryen pagesa për llogari të saj dhe për llogari të punonjësve të saj për të kontribuar për pensionet në përputhje me legjislacionin vendas. Kostot e paguara nga Shoqëria regjistrohen në pasqyrën e fitimit ose humbjes dhe të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse të të ardhurave në momentin kur ndodhin. Shoqëria ofron format e mëposhtme të përfitimeve për punonjësit e saj:

#### **(i) Kontributet e detyrueshme për sigurimet shoqërore**

Shoqëria paguan vetëm kontribute të detyrueshme të sigurimeve shoqërore të cilat sigurojnë benefite pensioni për punonjësit në moshën e pensionit. Instituti i Sigurimeve Shoqërore është përgjegjës për vendosjen e minimumit të detyrueshëm ligjor për pensionet sipas planit të përcaktuar të pensioneve, i cili është i detyrueshëm. Kontributet e Shoqërisë regjistrohen në pasqyrën e fitimit ose humbjes dhe të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse (fitim ose humbje) kur ndodhin.

#### **(ii) Leje vjetore e paguar**

Të gjithë punonjësit kanë të drejtën e lejes vjetore të paguar bazuar në legjislacionin aktual vendas.

#### **(iii) Sigurimi i shëndetit të punonjësve**

Shoqëria ka implementuar gjithashtu një plan të përcaktuar të sigurimit të shëndetit. Kontributi është i pagueshëm kundrejt një shoqërie sigurimi për të gjithë punonjësit që ofrojnë shërbimet e tyre për Shoqërinë dhe regjistrohet si shpenzim nën zërin “Shpenzime personeli”. Shoqëria bën pagesa fikse për çdo punonjës në bazë vjetore, dhe nuk ka asnjë detyrim tjetër kundrejt planit të sigurimit të shëndetit në fund të vitit.

#### **(iv) Plani privat i pensionit për punonjësit**

Shoqëria ka krijuar një Plan Pensioni Privat si benefit për punonjësit e saj. Shoqëria angazhohet të paguajë kontribute për secilin punonjës, i cili ka firmosur kontratën individuale të “Planit Privat të Pensionit” dhe ka punuar për Shoqërinë të paktën tre vite radhazi. Shpenzimi vjetor përfaqëson masën vjetore të kontributit të Shoqërisë dhe regjistrohet nën zërin “Shpenzime personeli”, duke ndikuar kështu në pasqyrën e fitimit ose humbjes së Shoqërisë, pa patur detyrime të ardhshme për Shoqërinë.

### **2.13 Provigjonet**

Provigjoni njihet nëse si rezultat i një ngjarjeje të kaluar, Shoqëria ka një detyrim aktual ligjor ose strukturor dhe nëse ekziston mundësia që të kërkohet një dalje burimesh e shprehur me përfitimet ekonomike për të shlyer detyrimin, e cila mund vlerësohet në mënyrë të besueshme. Provigjonet përcaktohen duke skontuar rrjedhat e ardhshme të parasë me një normë para tatimit, e cila paraqet vlerësimet aktuale të tregut për vlerën në kohë të parasë dhe rreziqet specifike që lidhen me atë detyrim

#### *Provigjon për detyrime koncesionare*

Shoqëria ka si detyrim koncesionar mirëmbajtjen e pistës së uljes së avioneve në një gjendje specifike, përpara se t'i dorëzojë pistën Qeverisë së Shqipërisë në fund të periudhës së koncesionit. Këto detyrime koncesionare janë njohur dhe matur sipas parashikimit më të mirë të shpenzimit që do të nevojitet për permbushjen e vlerës aktuale në datën e raportimit financiar të këtij detyrimi koncesionar. Detyrimet kontraktuale të Shoqërisë janë të tilla që parashikimi më i mirë i shpenzimeve të nevojshme për shlyerjen e detyrimit në çdo datë është në përpjesëtim të drejtë me peshën minimale të ngritjes së avionëve që përdorin pistën. Provigjoni është aktualizuar duke përdorur një faktor që skanton vlerën nominale të transaksionit në ekuivalentin e tij në para.

## **2. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE BAZË KONTABËL (VAZHDIM)**

### **2.14 Të ardhurat nga kontratat me konsumatorët**

Të ardhurat njihen në një shumë që reflekton shumën për të cilën Shoqëria pret të ketë të drejtë në këmbim të transferimit të mallrave ose shërbimeve për një konsumator (sipas SNRF 15). Shoqëria ka aplikuar standartin e ri të të ardhurave në datën 1 janar 2018 duke përdorur metodën e modifikuar të periudhave të mëparshme, që do të thotë se efekti i akumuluar i aplikimit është njohur në fitimet e mbartura më 1 janar 2018 dhe që pasqyrat krahasuese nuk ndryshojnë. SNFR 15 aplikohet me efekt prapaveprues vetëm për ato kontrata që nuk kanë përfunduar në datën e fillimit të aplikimit fillestar të standartit, që do të thotë 1 janar 2018.

Shoqëria manaxhon dhe përdor aeroportin për shërbime aeroportuale dhe jo-aeroportuale ofruar shoqërive ajrore dhe palëve të tjera të treta. Shoqëria nuk shet mallra si pjesë të aktivitetit të saj normal ekonomik dhe cdo shitje asetesh nuk është karakteristik e aktivitetit të përgjithshëm ekonomik. Shërbimet në përgjithësi ofrohen si pjesë e një pakete shërbimesh të cilat mund të ofrohen gjithashtu në mënyrë të papritur me kërkesë të klientit, sic parashtrahet në mënyrë të posacme në kontratat me klientët.

#### ***(i) Dhënia e shërbimeve***

Shoqëria ofron dy lloje shërbimesh, aeroportuale dhe jo-aeroportuale.

#### **Shërbimet aeroportuale**

Shoqëria ofron shërbime aeroportuale për shoqëritë ajrore që kryejnë aktivitetin e tyre në Aeroportin Ndërkombëtar të Tiranës, të cilat rregullohn nëpërmjet kontratave individuale me shoqëritë ajrore. Këto shërbime faturohen mbi bazën e një liste cmimesh të përcaktuar. Të ardhurat kryesore aeroportuale janë si më poshtë:

- Të ardhurat nga *shërbimet në tokë dhe uljes dhe ngritjes* llogariten në bazë të peshës minimale të ngritjes së secilit avion që përdor aeroportin.
- Shërbimet e *ndricimit* të aeroportit ofrohen pas kërkesës specifike të shoqërisë ajrore dhe të ardhurat përkatëse llogariten në bazë të peshës minimale të ngritjes së avionit që kërkon shërbimin.
- Të ardhurat nga *parkimi* janë llogaritur për cdo avion të parkuar në aeroport për një periudhë kohore nga 3 deri në 24 orë dhe llogariten në bazë të peshës minimale të ngritjes së avionit që parkon.
- Të ardhurat nga *pasagjerët* llogariten duke përdorur një tarifë fikse për pasagjerët në nisje që përdorin aeroportin.
- Të ardhurat nga *tarifa e sigurisë* llogariten duke përdorur një tarifë fikse për pasagjerët në nisje që përdorin aeroportin. Shoqëria ka detyrimin të paguajë 25% të kësaj tarife Autoritetit Shqiptar të Aviacionit Civil.

Të ardhurat e mësipërme përlllogariten për cdo fluturim dhe njihen në pasqyrën e të fitimit ose humbjes kur ndodhin. Faturat për shoqëritë ajrore për shërbimet e ofruara lëshohen dhe njihen në përputhje me kushtet e pagesave dhe faturimit të parashikuar në kontratë.

- Të ardhurat nga *shërbimet kargo* llogariten mbi bazën e peshës së postës dhe kargos të transportuara nga avionët, ndërsa të ardhurat nga magazinimi i kargos përlllogariten bazuar në ditët e qëndrimit të mallrave në të.

TIA ofron zbritje mbi xhiron të llogaritur mbi bazën e tarifave të saj të publikuara, dhe fton shoqëritë ajrore të shtojnë shërbime të tjera në TIA në mënyrë që të përfitojnë kosto operacionale të reduktuara. TIA nxit shoqëritë ajrore të fillojnë biznesin e tyre, të prezantojnë destinacione të reja dhe të zhvillojnë më tej aktivitetin e tyre në TIA. Kjo politikë rishikohet në bazë vjetore dhe politika aktuale është efektive nga data 1 janar 2016.

## **2. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE BAZË KONTABËL (VAZHDIM)**

### **2.14 Të ardhurat nga kontratat me konsumatorët (vazhdim)**

#### **Shërbimet jo-aeroportuale**

Shoqëria ofron shërbime jo-aeroportuale dhe gjeneron të ardhura nga kontratat nën-koncesionare dhe kontrata qiraje mbi asetet e saj, bazuar në natyrën e tyre, që konsistojnë në duty free, shitje me pakicë dhe bar-restorant, zyra dhe magazina.

Të ardhura të tjera përftohen nga shërbimet e reklamimit të ofruara palëve të treta nëpërmjet dhënies me qira të strukturave.

Të ardhurat nga *parkimi* përftohen nga kontrata e koncesionit mbi zonën e parkimit.

Shoqëria gjeneron të ardhura në formën e komisioneve duke vepruar si agjent në mbledhjen e tarifës së kalimit të kufirit. Bazuar në Udhëzimin për tarifën e kalimit të kufirit në fuqi nga 1 tetor 2014, Shoqëria ka të drejtë të mbajë 5% të shumës së mbledhur nga shoqëritë ajrore dhe të transferuar autoriteteve tatimore.

Këto shërbime ofrohen mbi bazën e kontratave individuale me klientët. Një subjekt një të ardhura nga shërbimet duke u bazuar në parimin e shkallës së përmbushjes së dhënies së shërbimit. Sipas SNRF 15, ngarkimi bëhet në bazë të cmimeve relative të identifikueshme. Atëherë, do të ndikohej ngarkimi i vlerave, dhe si rrjedhim, koha e njohjes së të ardhurave të lidhura me këto shitje.

Sidoqoftë, praktikat korrente të ndjekura nga Shoqëria, nuk ndryshojnë rrënjësisht nga ato të përshkruara në SNRF 15, si rrjedhojë nuk pritët ndonjë efekt i rëndësishëm.

#### **Balancat kontraktuale**

##### ***Aktivët kontraktuale***

Një aktiv kontraktual është e drejta në këmbim të mallrave dhe shërbimeve të transferuara tek konsumatori. Nëse Shoqëria operon duke transferuar shërbimet tek konsumatori përpara se ky i fundit të paguajë ose përpara afatit të pagesës, një aktiv kontraktual njihet në vlerën e pretendimit të përfutur, e cila është e kushtëzuar.

##### ***Llogari të arkëtueshme***

Një llogari e arkëtueshme përfaqëson të drejtën e Shoqërisë ndaj vlerës së një pretendimi të pakushtëzuar (që do të thotë se kërkohet vetëm kalimi i kohës në mënyrë që pagesa e pretendimit të jetë i pagueshëm). Referoju politikës kontabël të aktiveve financiare në seksionin p) Instrumentat financiarë – njohja fillestare dhe matja e mëtejshme.

##### ***Detyrimet kontraktuale***

Një detyrim kontraktual është detyrimi për të transferuar mallra ose shërbime tek një konsumator për të cilin Shoqëria ka marrë një pretendim (ose një pretendim është i pagueshëm). Nëse konsumatori paguan pretendimin përpara se Shoqëria të transferojë mallrat ose shërbimet tek ky i fundit, njihet një detyrim kontraktual në momentin që pagesa është bërë ose kur detyrimi është i pagueshëm (cilado të jetë më e hershme). Detyrimet kontraktuale njihen si të ardhura kur Shoqëria vepron sipas kontratës.

#### **Aktivët dhe detyrimet e lindura si rrjedhojë e të drejtës së kthimit**

##### ***Detyrime të rimbursueshme***

Një detyrim i rimbursueshëm është detyrimi për të rimbursuar disa pjesë të ose të gjithë pretendimin e marrë (ose të marrshëm) nga konsumatori dhe matet me vlerën përfundimtare që Shoqëria pret të kthejë tek konsumatori. Shoqëria rifreskon parashikimet e saj të detyrimeve të rimbursueshme në fund të cdo periudhe raportimi. Referoju politikave kontabël të pretendimeve të ndryshueshme.

## **2. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE BAZË KONTABËL (VAZHDIM)**

### **2.14 Të ardhurat nga kontratat me konsumatorët (vazhdim)**

#### *Kostot pasuese të ndërtimit*

Sikurse është parashtruar edhe në Notën 1.2 (Kontrata e Konçesionit) bazuar në Kontratën e Konçesionit Shoqëria ka detyrimin të mirëmbajtje dhe përmirësojë aeroportin gjatë gjithë kohëzgjatjes të kontratës. Sipas SNRF 15 dhe KIRFN 12 (të azhornuar), në zbatim të aplikimit të SNRF 15, ky konsiderohet një detyrim kontraktual i Shoqërisë. Përfitimi i Shoqërisë nga përmbushja e këtij detyrimi është e drejta për siguruar të ardhura nga përdoruesit e aeroportit. Si rrjedhojë e zbatimit të KIRFN 12 (të azhornuar) Shoqëria duhet të njohë të ardhura ndërkohë që përmbush detyrimin e saj dhe njeh të drejtën e saj të përdorimit si aktiv jo të trupëzuar e cila përfaqëson të drejtën e Shoqërisë për të krijuar të ardhura nga përdoruesit e aeroportit.

Shoqëria nuk krijon fitime nga shërbimet e ndërtimit pasi i siguron ato nga palë të treta. Si rrjedhojë, aktivi jo i trupëzuar matet me koston e realizuar për të përmbushur detyrimet e ndërtimit dhe mirëmbajtjes.

Shoqëria paraqet në pasyrën e të ardhurave ose humbjes dhe të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse si të ardhura dhe shpenzime koston vjetore të shërbimeve të mirëmbajtjes dhe përmirësimit siç kërkohet nga KIRFN 12 për të paraqitur zhvillimin e përmbushjes së këtij detyrimi kontraktual.

### **2.15 Pagesat e qirasë**

Shoqëria vlerëson në fazën fillestare të lidhjes së një kontrate, nëse kontrata është, ose përmban një qira. Kontrata është, ose përmban një qira, nëse kontrata jep të drejtën e kontrollit mbi përdorimin e një aktivi të identifikueshëm për një periudhë kohe në këmbim të një shume. Shoqëria përdor një qasje të vetme për njohjen dhe matjen e të gjitha qirave, përveç qirave afatshkurtra dhe qirave të aktiveve me vlerë të ulët. Shoqëria njeh detyrimet ndaj qirasë për të bërë pagesa të qirasë dhe të drejtën e përdorimit të aktiveve, e cila paraqet të drejtën për ta përdorur aktivin.

#### *E drejta e përdorimit të aktivit*

Shoqëria njeh të drejtën e përdorimit të aktivit në datën e fillimit të kontratës së qirasë. E drejta e përdorimit të aktivit matet me kosto, më pak se zhvlerësimi ose humbja nga zhvlerësimi. Kjo kosto përfshin shumën e detyrimeve të njohura të qirasë, kostot fillestare direkte dhe pagesat e qirasë të bëra në ose para datës së fillimit, pakësuar me çdo pagesë të marrë si nxitës. E drejta e përdorimit të aktiveve zhvlerësohet në mënyrë lineare përgjatë afatit të qirasë. Të drejtat e përdorimit të aktiveve paraqiten në Shënimin 6: Ndërtesa dhe Makineri, neto.

#### *Detyrimet e qirasë*

Në datën e fillimit të kontratës, Shoqëria njeh detyrimin e qirasë të matur me vlerën aktuale të kësteve të pagesave të qirasë të cilat nuk janë paguar ende në atë datë. Pagesat e qirasë përfshijnë pagesat fikse (pakësuar me çdo pagesë stimuluese të arkëtueshme). Pagesat e kryera për qiratë operationale njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve me metodën lineare përgjatë kohëzgjatjes së qirasë. Vlerat e marra si stimuj nxitës të qirasë janë njohur si pjesë përbërëse e shpenzimeve të qirasë, përgjatë afatit të qirasë.

### **2.16 Shpenzimi për tarifën e koncesionit**

Shpenzimi për tarifën e koncesionit paraqet një shumë të barabartë me 30% të Fitimit të Shpërndashëm të Shoqërisë, të akumuluar dhe të regjistruar si të pagueshëm për Qeverinë e Shqipërisë, siç është përcaktuar në kontratën e koncesionit me Qeverinë e Shqipërisë. Shpenzimi për tarifën e koncesionit njihet si shpenzim në vitin kur ndodh.

## **TIRANA INTERNATIONAL AIRPORT SH.P.K.**

### **Shënime mbi Pasqyrat Financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020**

---

*(të gjitha shumat janë të shprehura në Lek, përveçse kur është shprehur ndryshe)*

## **2. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE BAZË KONTABËL (VAZHDIM)**

### **2.17 Të ardhurat dhe shpenzimet financiare**

Të ardhurat financiare përfshijnë të ardhurat nga interesi nga fondet e investuara në depozita bankare, dhe fitimet nga kursi i këmbimit. Të ardhurat nga interesi njihen, kur ato ndodhin, në pasqyrën e fitimit ose humbjes dhe të ardhurave të tjera gjithpërfshirëse (fitim ose humbje) dhe përlogariten duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Shpenzimet financiare përfshijnë shpenzimet e interesit për huatë, skonto të pazbritshme mbi provigjonet, humbjet nga kursi i këmbimit, dhe humbje nga rënia në vlerë e aktiveve financiare (nëse ka).

### **2.18 Kostot e huamarrjes**

Kostot e huamarrjes, që janë direkt të lidhura me blerjen, ndërtimin ose prodhimin e aktiveve kualifikuese, të cilat janë aktive që marrin kohë që të jenë gati për t'u përdorur, duke filluar nga 1 janar 2009 i janë shtuar kostos së këtyre aktiveve, deri në periudhën që aktivet janë gati për përdorim apo shitje.

Të gjitha kostot e tjera të huamarrjes njihen në pasqyrën e fitimit ose humbjes dhe të ardhurave të tjera gjithpërfshirëse (fitim ose humbje) në periudhën në të cilën ndodhin.

### **2.19 Tatim fitimi**

Shpenzimi i tatim fitimit përfaqëson shumën e detyrimit tatimor dhe tatimit të shtyrë.

#### *Tatim fitimi i vitit*

Tatimi aktual bazohet mbi fitimin e tatueshëm të vitit. Tatim fitimi njihet në pasqyrën e fitimit ose humbjes.

Tatimi aktual është shuma e pritur e tatimit të pagueshëm mbi fitimin e tatueshëm të vitit, duke aplikuar normat tatimore në fuqi në datën e raportimit, si dhe çfarëdolloj rregullimi kontabël të tatimit për t'u paguar në lidhje me vitet e mëparshme.

#### *Tatimi i shtyrë*

Tatimi i shtyrë njihet si diferenca e përkohshme mes vlerës kontabël të aktiveve dhe detyrimeve në pasqyrat financiare dhe bazës së tatueshme korresponduese përdorur në llogaritjen e fitimit të tatueshëm.



## **2. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE BAZË KONTABËL (VAZHDIM)**

### **2.18 Tatim fitimi (vazhdim)**

Detyrimet e tatimit të shtyrë në përgjithësi llogariten për të gjitha diferencat e tatueshme të përkohshme. Aktivitetet e tatimit të shtyrë në përgjithësi njihen për të gjitha diferencat e zbritshme të përkohshme në masën që ekziston mundësia që fitimi i tatueshëm do të jetë i mundshëm në mënyrë që këto diferencat të zbritshme të përkohshme të mund të përdoren. Këto aktive dhe detyrime të tatimit të shtyrë nuk do të njihen në qoftë se këto diferencat rezultojnë nga njohja fillestare e aktiveve dhe detyrimeve në një transaksion që nuk prek as fitimin e tatueshëm, as fitimin kontabël.

Vlera kontabël e aktiveve dhe detyrimeve të tatimit të shtyrë rishikohet në fund të çdo periudhe raportuese dhe reduktohet në masën që nuk është më e mundur që të arrihet një fitim i tatueshëm i mjaftueshëm që të lejojë që një pjesë ose i gjithë aktivi të rikuperohet. Detyrimet dhe aktivitetet e tatimit të shtyrë maten me normën e tatimit që pritet të përdoret në periudhën në të cilën detyrimi ka ndodhur ose aktivi është realizuar, bazuar në normat e tatimit dhe legjislacionit fiskal që ka qenë në fuqi ose ka hyrë në fuqi në fund të periudhës së raportimit.

#### *Tatim fitimi dhe tatimi i shtyrë i vitit*

Tatim fitimi dhe tatimi i shtyrë i vitit njihen në pasqyrën e fitimit ose humbjes dhe të ardhurave të tjera gjithpërfshirëse, përveçse kur lidhen me zëra që njihen në të ardhura të tjera gjithpërfshirëse ose drejtpërdrejtë në kapital, rast në të cilin tatim fitimi dhe tatimi i shtyrë njihen gjithashtu në të ardhura të tjera gjithpërfshirëse ose drejtpërdrejtë në pasqyrën e kapitalit përkatësisht.

### **2.20 Kompensimi**

Shoqëria nuk neton aktivitetet dhe detyrimet apo të ardhurat dhe shpenzimet, vetëm përveçse kur kjo kërkohet ose lejohet nga ndonjë SNRF. Gjithashtu, Shoqëria paraqet në bazë neto fitimet dhe humbjet e krijuara nga një grup i ngjashëm transaksionesh si psh: fitimi dhe humbja nga kursi i këmbimit. Gjithsesi Shoqëria i paraqet veçmas fitimet dhe humbjet e tilla, nëse vlerat janë materiale.

### **2.21 Përcaktimi i vlerës së drejtë**

Disa nga politikat kontabël të Shoqërisë dhe shënimeve shpjeguese kërkojnë përcaktimin e vlerës së drejtë, për aktivitetet dhe detyrimet financiare dhe jo-financiare. Vlera e drejtë është përcaktuar për qëllime matjeje dhe / ose prezantimi bazuar në metodat në vijim.

Drejtimi i Shoqërisë vlerëson që vlera e drejtë e parasë dhe e parasë së ngurtësuar, llogarive të arkëtueshme, llogarive të pagueshme, aktiveve të tjera afatshkurtra dhe detyrimeve të tjera afatshkurtra, detyrimet për tatim fitimin dhe tarifet së pagueshme të koncesionit, përafrohet me vlerën kontabile kryesisht për shkak të maturitetit afatshkurtër të këtyre instrumentave.

**TIRANA INTERNATIONAL AIRPORT SH.P.K.****Shënime mbi Pasqyrat Financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020***(të gjitha shumat janë të shprehura në Lek, përveçse kur është shprehur ndryshe)***2. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE BAZË KONTABËL (VAZHDIM)****2.20 Përcaktimi i vlerës së drejtë (vazhdim)***Kredi bankare dhe hua të tjera*

Vlera e drejtë, e cila është llogaritur për qëllime pasqyrimi, është llogaritur si vlera aktuale e flukseve të ardhshme të principalit dhe interesave, të skontuara duke përdorur normën e interesit të tregut në datën e raportimit.

Më poshtë është një krahasim, sipas kategorive, e vlerës së mbartur dhe vlerës së drejtë të aktiveve dhe detyrimeve financiare të Shoqërisë:

	31 dhjetor 2020		31 dhjetor 2019	
	Vlera e mbartur	Vlera e drejtë	Vlera e mbartur	Vlera e drejtë
<b>Aktivet financiare</b>				
Llogari të arkëtueshme, neto	1,580,683,798	1,580,683,798	1,668,691,049	1,668,691,025
Aktive të tjera	476,924,732	476,924,732	272,482,050	272,482,050
Para në arkë dhe bankë	812,990,247	812,990,294	3,023,565,701	3,023,565,661
<b>Totali i aktiveve financiare</b>	<b>2,870,598,777</b>	<b>2,870,598,824</b>	<b>4,964,738,800</b>	<b>4,964,738,736</b>
<b>Detyrimet financiare</b>				
Kredi bankare dhe hua të tjera	-	-	1,166,077,922	1,141,714,207
Detyrime të tjera	1,607,175,837	1,574,473,227	1,818,280,965	1,772,850,084
Llogari të pagueshme	261,194,999	261,194,999	289,788,925	289,788,977
Divident i pagueshëm	587,575,000	587,575,000	-	-
Tarifa e pagueshme e koncensionit	886,965,492	886,965,492	747,551,144	747,551,144
<b>Totali i detyrimeve financiare</b>	<b>3,342,911,328</b>	<b>3,310,208,718</b>	<b>4,021,698,956</b>	<b>3,951,904,412</b>

Aktive të tjera dhe detyrime të tjera të paraqitura në tabelën e mësipërme përfaqësojnë vetëm ato balanca të cilat janë konsideruar si aktive financiare dhe detyrime financiare.

Më poshtë është një krahasim i vlerës së mbartur dhe vlerës së drejtë, duke treguar shkallën e instrumentave financiarë, përkatësisht në 31 dhjetor 2020 dhe 31 dhjetor 2019:

	Vlera e mbartur	Vlera e drejtë		
		Niveli 1 (çmime të kuotuarat në tregun aktiv)	Niveli 2 (burime të dukshme të rëndësishme)	Niveli 3 (burime të padukshme të rëndësishme)
<b>31 dhjetor 2020</b>				
<b>Detyrime financiare</b>				
<b>Detyrime të tjera</b>				
- Kredia e mëparshme	180,087,322	-	180,087,322	-

**TIRANA INTERNATIONAL AIRPORT SH.P.K.****Shënime mbi Pasqyrat Financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020***(të gjitha shumat janë të shprehura në Lek, përveçse kur është shprehur ndryshe)***2. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE BAZË KONTABËL (VAZHDIM)****2.20 Përcaktimi i vlerës së drejtë (vazhdim)**

	Vlera e mbartur	Vlera e drejtë		
		Niveli 1 (çmime të kuotuar në tregun aktiv)	Niveli 2 (burime të dukshme të rëndësishme)	Niveli 3 (burime të padukshme të rëndësishme)
<b>31 dhjetor 2019</b>				
<b>Detyrime financiare</b>				
<b>Detyrime të tjera</b>				
- Kredia e mëparshme	221,945,030	-	176,514,062	-
<b>Kredi bankare dhe hua të tjera</b>	<b>1,166,077,922</b>	-	<b>1,141,714,207</b>	-
- Kredi me interes të pandryshueshëm	797,478,062	-	777,981,035	-
- Kredi me interes të ndryshueshëm	368,599,860	-	363,733,172	-

Nuk ka patur transferime midis Nivelit 1 dhe Nivelit 2 gjatë vitit 2020 dhe 2019. Metodrat dhe supozimet e mëposhtme janë përdorur për të parashikuar vlerën e drejtë:

- Shoqëria ka paguar plotësisht shumën e mbetur të huave gjatë vitit 2020. Vlera e drejtë e kredive dhe huave të tjera të Shoqërisë janë përcaktuar duke përdorur metodën e flukseve të skontuara duke përdorur si normë skontimi normën e interesit të kredidhënësit në datën e raportimit. Risku i mospërpunueshëm për Shoqërinë në datën 31 dhjetor 2020 u vlerësua si jo-material.

Burimet e padukshme të rëndësishme të përdorura në matjen e vlerës së drejtë, të kategorizuar në Nivelin 2 të shkallës së vlerës së drejtë, së bashku me një analizë sasiore të ndjeshmërisë në 31 dhjetor 2019 është paraqitur më poshtë:

	Medodat e vlerësimit	Burime të padukshme të rëndësishme	Interval (Mesatare e ponderuar)	Ndjeshmëria e burimeve në vlerën e drejtë
Kredi bankare dhe hua të tjera	Metoda e flukseve të skontuara të parasë	Norma e skontimit	2019: 1% - 5.59%	0.25% rritje (zvogëlim) në normën e skontimit do të rezultonte në një rritje (zvogëlim) të vlerës së drejtë të kredive bankare dhe huave të tjera me Lek 189,961

### **3. PËRDORIMI I VLERËSIMEVE DHE GJYKIMEVE**

Përgatitja e pasqyrave financiare në përputhje me SNRF kërkon që Drejtimi të kryejë gjykime, vlerësime dhe supozime, të cilat ndikojnë në aplikimin e politikave dhe shumave të raportuara të aktiveve dhe detyrimeve, të ardhurave dhe shpenzimeve. Rezultatet aktuale mund të ndryshojnë nga këto supozime.

Vlerësimet dhe supozimet rishikohen në mënyrë të vazhdueshme. Rishikimet e vlerësimeve kontabël njihen në periudhën në të cilën vlerësimi rishikohet dhe në periudhat e ardhshme, nëse ato ndikohen.

Informacioni për elemente të rëndësishëm në vlerësimin e pasigurive dhe gjykime kritike për aplikimin e politikave kontabël që kanë efekt material në vlerat kontabël në pasqyrat financiare jepet në paragrafin e mëposhtëm ashtu si edhe në shënimet shpjeguese të mëposhtme:

- (i) shënimi 9 – Llogari të arkëtueshme, neto
- (ii) shënimi 15 – Provigjon për detyrimet koncesionare
- (iii) shënimi 23 – Tatim fitimi
- (iv) interesi i mbetur i koncesionit

Sic është detajuar në shënimin 1.2 Kontrata e Koncesionit-Dorëzimi, Shoqëria ka të drejtën të marrë një pagesë në këmbim të aseteve dhe mjediseve të dorëzuara, sic është qartësisht e përcaktuar në Seksionin 29 të Kontratës së Koncesionit, të barabartë me vlerën neto kontabile në momentin e dorëzimit të këtyre aseteve, të rishikuar nga një ekspert i pavarur vlerësimi. Sic është përshkruar në Shënimin 2.7.iv, Shoqëria amortizon asetet e saj për një periudhë të barabartë ose më të vogël se periudha e mbetur e koncesionit dhe nuk pret që vlera e mbetur kontabël e aseteve dhe mjediseve të saj të jetë e konsiderueshme në datën dorëzimit. Sidoqoftë, kjo është e pasigurt dhe nuk është një e drejtë kontraktuale e pakushtëzuar e Shoqërisë, për rrjedhje Shoqëria nuk mund të masë në mënyrë të besueshme apo të parashikojë vlerën e drejtë të një aseti financiar të mundshëm që mund të rezultojë nga dorëzimi i Koncesionit.

#### **4. MIRATIMI I INTERPRETIMEVE DHE STANDARDEVE TË REJA OSE TË RISHIKUARA**

##### **(i) Standardet e miratuara dhe efektive për periudhën aktuale**

Disa ndryshime dhe interpretime zbatohen për herë të parë në vitin 2020, por nuk kanë ndikim në pasqyrat financiare të Shoqërisë, përfshirë ndryshimin e SNK 1, i cili përshkruhet në disa detaje më poshtë. Shoqëria nuk ka miratuar herët ndonjë standard, interpretim ose ndryshim që është lëshuar, por nuk janë ende efektive.

##### **• SNK 1 Prezantimi i Pasqyrave Financiare dhe SNK 8 Politikat e Kontabilitetit, Ndryshimet në Vlerësimet Kontabël dhe Gabimet: Përkufizimi i ‘materialit’ (Ndryshimet)**

Ndryshimet janë efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2020 dhe janë te lejueshme për t’u zbatuar më herët. Ndryshimet sqarojnë përkufizimin e materialit dhe mënyrën se si duhet të zbatohet.

Në përkufizimin e ri thuhet se, ‘Informacioni është material nëse mungesa, paraqitja e gabuar ose e paqartë, ka pritshmëri të arsyeshme që të ndikojë në vendimet që përdoruesit kryesorë të pasqyrave financiare të përgjithshme mund të marrin në bazë të atyre pasqyrave financiare, të cilat japin informacion financiar rreth një njësie ekonomike të caktuar’.

Për më tepër, shpjegimet që shoqërojnë përkufizimin janë përmirësuar. Ndryshimet gjithashtu sigurojnë që përcaktimi i materialit është konsistent në të gjithë Standardet e SNRF-ve.

Drejtimi ka bërë një vlerësim të efektit të standardit dhe konsideron se standardi i ri nuk ka efekt në pasqyrat financiare të shoqërisë.

Standardet, ndryshimet dhe përmirësimet e reja në vijim janë bërë efektive në 1 Janar 2020 megjithatë nuk janë të zbatueshme për Shoqërinë.

- Ndryshimet në SNRF 3: Kombinimet e Biznesit,
- Ndryshimet në SNRF 9, SNK 39 dhe SNRF 7: Reforma e Vlerësimit të Normës së Interesit,
- Ndryshimet në Kuadrin Konceptual të SNRF-ve

##### **• IFRS 16 Qiratë – Marrëveshje qiraje të lidhura me Covid-19 (Ndryshim)**

Ndryshimi zbatohet, në retrospektivë, për periudhat vjetore të raportimit që fillojnë në ose pas 1 qershorit 2020. Zbatimi i mëparshëm është i lejuar, përfshirë në pasqyrat financiare ende të pa autorizuara për t’u lëshuar në 28 maj 2020. IASB ndryshoi standardin për t’u krijuar lehtësi qiramarrëse në zbatimin udhëzimeve për kontabilitetin e modifikimit të qirasë për kontratat e qirasë sipas SNRF 16, që vijnë si pasojë e drejtpërdrejtë e pandemisë covid-19. Ndryshimi siguron një lehtësim praktik që qiramarrësi të llogarisë çdo ndryshim në pagesat e qirasë që rezultojnë nga kontrata e qirasë në lidhje me covid-19 në të njëjtën mënyrë që do të llogariste ndryshimin sipas SNRF 16, nëse ndryshimi nuk ishte një modifikim i qirasë, vetëm nëse plotësohen të gjitha kushtet e mëposhtme:

- Ndryshimi në pagesat e qirasë rezulton në konsideratë të rishikuar për qiranë që është në thelb e njëjtë me, ose më pak se, shpërblimin për qiranë menjëherë para ndryshimit.
- Çdo ulje e pagesave të qirasë ndikon vetëm në pagesat që fillimisht u paguan më ose para 30 Qershorit 2021.
- Nuk ka asnjë ndryshim thelbësor në termat dhe kushtet e tjera të qirasë.

Shoqëria nuk ka ndikim nga ky ndryshim duke qenë se nuk ka marrje me qira dhe gjithashtu asetet me të drejtë përdorimi nuk janë domethënëse.

##### **(i) Standardet dhe Ndryshimet të lëshuara por jo ende efektive dhe të pazbatuara më herët**

Standardet dhe ndryshimet e mëposhtme do të miratohen nga Shoqëria kur ato të bëhen efektive, megjithatë, këto nuk do të kenë ndikim në pasqyrat financiare të Shoqërisë.

**4. MIRATIMI I INTERPRETIMEVE DHE STANDARDEVE TË REJA OSE TË RISHIKUARA (VAZHDIM)**

- **SNK 1: Prezantimi i Pasqyrave Financiare: Detyrimet afatshkurtra dhe afatgjata (Ndryshimet)** - efektive për periudhat raportuese që fillojnë më ose pas 1 Janarit 2023
- **Reforma e normës së interesit që shërben si standard krahasues (benchmark) - SNRF 9, SNK 39, SNRF 7, SNRF 4 & SNRF 1 (Ndryshimet) – faza 2.**
- **SNRF 3 Kombinimet e Biznesit; SNK 16 Aktivët afatgjata materiale; SNK 37 Provizionet, Detyrimet e Kushtëzuara dhe Aktivët e Kushtëzuara si dhe Përmirësimet Vjetore 2018-2020 (Ndryshimet)**

Ndryshimet janë efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2022 me leje të zbatimit të mëparshëm. BSNK ka lëshuar ndryshime të fushës së ngushtë në Standardet e SNRF si më poshtë:

- **SNRF 3 Kombinimet e Biznesit (Ndryshimet)** azhurnojnë një referencë në SNRF 3 në Kuadrin Konceptual për Raportimin Financiar pa ndryshuar kërkesat e kontabilitetit për kombinimet e biznesit. Standarti nuk është i aplikueshëm për Shoqërinë.
- **SNK 16 Ndërtesat, Impiantet dhe Pajisjet (Ndryshimet)** ndalojnë që një Shoqëri të zbresë nga kostoja e aktiveve afatgjata materiale shumtë e marra nga shitja e aktiveve të prodhuar ndërsa shoqëria është duke përgatitur aktivin për përdorimin e tij të synuar. Në vend të kësaj, një shoqëri do të njohë të ardhurat e tilla të shitjeve dhe koston e lidhur në fitim ose humbje. Shoqëria nuk ka aktivitete të tilla.
- **SNK 37 Provizionet, Detyrimet e Kushtëzuara dhe Aktivët e Kushtëzuara (Ndryshimet)** specifikojnë cilat kosto përfshin një shoqëri në përcaktimin e kostos së përmbushjes së një kontrate për qëllimin e vlerësimit nëse një kontratë është me kushte rënduese. Shoqëria nuk pret të ketë ndikim të rëndësishëm nga ky ndryshim.
- **Përmirësimet Vjetore 2018-2020** bëjnë ndryshime të vogla në SNRF 1 Adoptimi për herë të parë i Standardeve Ndërkombëtare të Raportimit Financiar, SNRF 9 Instrumentet Financiare, SNK 41 Bujqësia dhe Shembuj ilustrues shoqëruar të SNRF 16 Qiratë. Këto standarte nuk kanë rëndësi të vecantë për Shoqërinë dhe nuk priten ndikime të rëndësishme.

**5. MANAXHIMI I RREZIKUT FINANCIAR**

Shoqëria është e ekspozuar ndaj rreziqeve të mëposhtme nga përdorimi i instrumenteve financiare:

- rreziku i kredisë,
- rreziku i likuiditetit, dhe
- rreziku i tregut.

Ky shënim paraqet informacion rreth ekspozimit të Shoqërisë ndaj secilit prej rreziqeve të mësipërm, objektivat, politikat dhe proceset e Shoqërisë për matjen dhe manaxhimin e rrezikut dhe manaxhimin e kapitalit. Shënime të mëtejshme sasiore janë të përfshira në këto pasqyra financiare.

Politikat e manaxhimit të rrezikut të Shoqërisë janë vendosur për të identifikuar dhe analizuar rreziqet që përball Shoqëria, për të vendosur limitet dhe kontrollat e përshtatshme, dhe për të monitoruar rreziqet dhe zbatimin e limiteve. Politikat dhe sistemet e manaxhimit të rrezikut rishikohen rregullisht për të reflektuar ndryshimet në kushtet e tregut dhe në aktivitetet e Shoqërisë. Shoqëria, përmes trajnimeve dhe standardeve dhe procedurave të manaxhimit, synon të zhvillojë një ambient kontrolli konstruktiv dhe të disiplinuar, në të cilin të gjithë punonjësit i kuptojnë rolet dhe detyrimet e tyre.

**5. MANAXHIMI I RREZIKUT FINANCIAR (VAZHDIM)**

Këshilli Administrativ i Shoqërisë (duke vepruar në emër të Komitetit të Kontrollit) vrojton se si Drejtimi monitoron përputhjen me politikat e procedurat e manaxhimit të rrezikut të Shoqërisë dhe rishikon përshtatjen e strukturës së manaxhimit të rrezikut në lidhje me rreziqet që përballet Shoqëria. Këshilli Administrativ i Shoqërisë ndihmohet nga Kontrolli i Brendshëm. Ky kryen rregullisht rishikime ad-hoc të procedurave dhe kontrolleve të drejtimin të rrezikut, rezultatet e të cilave raportohen tek Këshilli Administrativ

**Rreziku i kredisë**

Rreziku i kredisë është rreziku i humbjeve financiare për Shoqërinë nëse një klient ose palë tjetër nuk përmbush detyrimet kontraktuale dhe vjen kryesisht nga llogaritë e arkëtueshme të Shoqërisë. Shoqëria është e ekspozuar kundrejt riskut të kredisë për shkak të veprimtarisë së saj operacionale (kryesisht llogaritë e arkëtueshme) dhe prej veprimtarisë së saj financiare, duke përfshirë këtu depozitat me bankat dhe institucionet financiare.

Për shkak të volumit të madh të llogarive të arkëtueshme që vijnë nga një numër i kufizuar i linjave ajrore, ekziston një shkallë përqendrimi në rrezikun e kredisë për disa prej tyre, ku p.sh. më 31 dhjetor 2020, dy klientë mbulojnë 60.3% të llogarive të arkëtueshme neto (më 31 dhjetor 2019: 64%). Gjithashtu, Shoqëria ka një bazë të ndryshme klientësh të vegjël për shërbimet e tjera jo-aeronautike, për të cilat ka një përqendrim të kufizuar të rrezikut të kredisë. Zhvlerësimi për llogaritë e arkëtueshme të dyshimta paraqitet në shumën e konsideruar të nevojshme për të mbuluar rreziqet e mundshme në arkëtimin e llogarive të arkëtueshme (shih shënimin 24.1).

**Rreziku i likuiditetit**

Rreziku i likuiditetit është rreziku që Shoqëria të mos jetë në gjëndje të përmbushë detyrimet e saj në kohën e maturimit të tyre. Mënyra që ndjek Shoqëria në drejtimin e rrezikut të likuiditetit është të sigurojë se do të ketë vazhdimisht likuiditet të mjaftueshëm për të shlyer detyrimet e saj në kohë, në kushte normale dhe të vështira, pa shkaktuar humbje të papranueshme dhe pa rrezikuar reputacionin e Shoqërisë. Shoqëria gjeneron rrjedhje parash të konsiderueshme nga aktivitetet e saj operative në masën që ajo beson që rreziku i saj i likuiditetit është i pakonsiderueshëm (shënimi 24.2).

*Ndikimi në likuiditet*

Volumi i financimit të shitjeve është zvogëluar së fundmi në mënyrë të ndjeshme. Këto rrethana mund të ndikojnë në aftësinë e Shoqërisë për të marrë hua të reja, nëse do të lindi nevoja, të rifinancojë huatë ekzistuese me kushte të ngjashme me ato të transaksioneve të mëparshme.

*Ndikimi në klientë dhe huadhënës*

Debitorët e Shoqërisë mund të preken nga mungesa e likuiditetit, e cila mund të ndikojë në aftësinë paguese të borxheve që ata kanë ndaj Shoqërisë. Përkeqësimi i kushteve operative mund të ndikojë edhe në parashikimin e rrjedhave financiare nga ana e Drejtimit dhe përcaktimin e zhvlerësimit të aktiveve financiare dhe jo-financiare. Me supozimin që një informacion i tillë është i disponueshëm, Drejtimi ka rivlerësuar në mënyrën e duhur rrjedhjet e ardhshme të pritshme dhe vlerësimin e provigjoneve.

**Rreziku i tregut**

Rreziku i tregut është rreziku që ndryshimet në çmimet e tregut, si kurset e këmbimit dhe normat e interesit, do të ndikojnë tek të ardhurat e Shoqërisë. Objektivi i drejtimit të rrezikut të tregut është të kontrollojë se ekspozimet e tregut janë brenda parametrave të pranueshëm, përfshirë këtu edhe trafikun ajror duke optimizuar kthimin.

*Rreziku i normave të interesit*

Gjatë vitit 2020, Shoqëria ka paguar plotësisht vlerën e mbetur të huave. Për rrjedhojë Shoqëria ka një ekspozim minimal ndaj riskut të normave të interesit.

## **5. MANAXHIMI I RREZIKUT FINANCIAR (VAZHDIM)**

### *Rreziku i kursit të këmbimit*

Shoqëria nuk përballet me rreziqe të rëndësishme të kursit të këmbimit nga veprimtaria normale. Shoqëria ka gjendje të konsiderueshme në Euro nga klientët e saj dhe kundrejt furnitorëve të saj, fakt i cili e mbron Shoqërinë ndaj rrezikut të kursit të këmbimit. Drejtimi nuk ka hyrë në ndonjë marrëveshje derivative për t'u mbrojtur nga ky rrezik.

### **Analiza e ndjeshmërisë**

Me anën e manaxhimit të rrezikut të normave të interesit dhe të kursit të këmbimit, Shoqëria synon të reduktojë ndikimin e luhatjeve afatshkurtra në fitimet e Shoqërisë. Në një periudhë afatgjatë, sidoqoftë, ndryshimet e vazhdueshme në kurset e këmbimit dhe normat e interesit mund të kenë një ndikim në fitim. Më 31 dhjetor 2020 është vlerësuar se një ndryshim në përqindjen e normave të interesit në vlerën e Lek-ut kundrejt monedhave të tjera nuk do të ketë ndikim të konsiderueshëm në fitimin e Shoqërisë para tatimit mbi fitimin.

### **Manaxhimi i kapitalit**

Politika e Shoqërisë është të mbajë një bazë të fortë kapitali në mënyrë që të ruajë besueshmërinë e investitorëve dhe kreditorëve dhe të mbështesë zhvillimin e mëtejshëm të biznesit. Drejtimi monitoron kthimet nga kapitali, të cilat Shoqëria i përcakton si të ardhura neto të shfrytëzimit ndaj totalit të kapitalit, duke përfshirë aksionet e preferuara të parevokueshme dhe interesat e pakicës. Drejtimi gjithashtu monitoron nivelin e dividendëve ndaj ortakut. Gjatë këtij viti nuk ka patur ndryshime në mënyrën e manaxhimit të kapitalit. Shoqëria nuk është subjekt i kërkesave të kapitalit të vendosura nga ente rregullatore.



**TIRANA INTERNATIONAL AIRPORT SH.P.K.**
**Shënime mbi Pasqyrat Financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020**
*(të gjitha shumat janë të shprehura në Lek, përveçse kur është shprehur ndryshe)*
**6. AKTIVE TË TRUPËZUARA, NETO**

	Përmirësimet e ndërtesave ekzistuese	Toka	Makineri dhe pajisje	Kompjutera dhe pajisje zyre	Automjete	E drejta e përdorimit të aktiveve	Parapagime për aktive të trupëzuara	Totali
<b>Kosto</b>								
<b>Më 1 janar 2019</b>	<b>47,932,379</b>	<b>4,465,212</b>	<b>445,263,445</b>	<b>555,097,741</b>	<b>314,519,085</b>	-	<b>24,379,153</b>	<b>1,391,657,015</b>
Shtesa	-	-	51,392,444	48,789,130	15,299,699	38,457,925	42,788,140	<b>196,727,338</b>
Transferime	-	-	47,407,381	12,268,175	1,851,045	-	(61,526,601)	-
Pakësime	-	-	(5,323,032)	(25,297,545)	-	-	-	<b>(30,620,577)</b>
Diferenca konvertimi	(640,808)	(59,695)	(7,077,927)	(5,582,417)	(4,392,984)	(477,741)	157,265	<b>(18,074,307)</b>
<b>Më 31 dhjetor 2019</b>	<b>47,291,571</b>	<b>4,405,517</b>	<b>531,662,311</b>	<b>585,275,084</b>	<b>327,276,845</b>	<b>37,980,184</b>	<b>5,797,957</b>	<b>1,539,689,469</b>
Shtesa	-	-	3,881,332	57,479,138	1,576,509	2,401,503	22,522,113	<b>87,860,595</b>
Transferime	-	-	4,925,621	23,399,164	-	-	(28,324,785)	-
Pakësime	-	-	(12,365,996)	(43,202,074)	(1,858,313)	(1,849,016)	-	<b>(59,275,399)</b>
Diferenca konvertimi	749,551	69,825	9,495,200	12,438,686	5,425,701	586,464	4,715	<b>28,770,142</b>
<b>Më 31 dhjetor 2020</b>	<b>48,041,122</b>	<b>4,475,342</b>	<b>537,598,468</b>	<b>635,389,998</b>	<b>332,420,742</b>	<b>39,119,135</b>	-	<b>1,597,044,807</b>
<b>Zhvlerësim i akumuluar</b>								
<b>Më 1 janar 2019</b>	<b>(22,763,955)</b>	-	<b>(320,600,976)</b>	<b>(451,696,465)</b>	<b>(221,077,272)</b>	-	-	<b>(1,016,138,668)</b>
Zhvlerësimi për vitin	(2,889,838)	-	(42,924,069)	(42,623,402)	(24,622,749)	(9,602,681)	-	<b>(122,662,739)</b>
Pakësime	-	-	3,250,558	23,459,585	-	-	-	<b>26,710,143</b>
Diferenca konvertimi	336,592	-	4,459,990	4,180,288	3,224,496	90,861	-	<b>12,292,227</b>
<b>Më 31 dhjetor 2019</b>	<b>(25,317,201)</b>	-	<b>(355,814,497)</b>	<b>(466,679,994)</b>	<b>(242,475,525)</b>	<b>(9,511,820)</b>	-	<b>(1,099,799,037)</b>
Zhvlerësimi për vitin	(2,924,369)	-	(53,516,689)	(56,297,975)	(24,524,423)	(9,705,789)	-	<b>(146,969,245)</b>
Pakësime	-	-	10,206,022	41,550,874	1,858,314	1,849,017	-	<b>55,464,227</b>
Diferenca konvertimi	(387,558)	-	(6,245,673)	(10,341,883)	(3,950,166)	(107,124)	-	<b>(21,032,404)</b>
<b>Më 31 dhjetor 2020</b>	<b>(28,629,128)</b>	-	<b>(405,370,837)</b>	<b>(491,768,978)</b>	<b>(269,091,800)</b>	<b>(17,475,716)</b>	-	<b>(1,212,336,459)</b>
<b>Vlera neto</b>								
<b>Më 31 dhjetor 2019</b>	<b>21,974,370</b>	<b>4,405,517</b>	<b>175,847,814</b>	<b>118,595,090</b>	<b>84,801,320</b>	<b>28,468,364</b>	<b>5,797,957</b>	<b>439,890,432</b>
<b>Më 31 dhjetor 2020</b>	<b>19,411,994</b>	<b>4,475,342</b>	<b>132,227,631</b>	<b>143,621,020</b>	<b>63,328,942</b>	<b>21,643,419</b>	-	<b>384,708,348</b>

**TIRANA INTERNATIONAL AIRPORT SH.P.K.**
**Shënime mbi Pasqyrat Financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020**
*(të gjitha shumat janë të shprehura në Lek, përveçse kur është shprehur ndryshe)*
**7. AKTIVE TË PATRUPËZUARA, NETO DHE PUNIME NË PROÇES**

	Aktive të patrupëzuara nga Kontrata e Koncesionit					Totali
	Pagesa koncesionare	Kredia e mëparshme	Terminali i ri i pasagjerëve dhe terminali ekzistues	Punime në proçes	Aktive të tjera të patrupëzuara	
<b>Kosto</b>						
<b>Më 1 janar 2019</b>	<b>370,260,000</b>	<b>827,882,724</b>	<b>8,501,868,898</b>	<b>213,686,056</b>	<b>405,681</b>	<b>9,914,103,359</b>
Shtesa	-	-	12,875,717	736,149,392	-	<b>749,025,109</b>
Transferime	-	-	230,801,827	(230,801,827)	-	-
Diferenca konvertimi	(4,950,000)	(11,067,951)	(119,983,957)	(1,604,965)	(5,423)	<b>(137,612,296)</b>
<b>Më 31 dhjetor 2019</b>	<b>365,310,000</b>	<b>816,814,773</b>	<b>8,625,562,485</b>	<b>717,428,656</b>	<b>400,258</b>	<b>10,525,516,172</b>
Shtesa	-	-	11,085,864	729,888,109	-	<b>740,973,973</b>
Transferime	-	-	26,184,364	(26,184,364)	-	-
Diferenca konvertimi	5,790,000	12,946,148	136,681,333	9,775,884	6,344	<b>165,199,709.00</b>
<b>Më 31 dhjetor 2020</b>	<b>371,100,000</b>	<b>829,760,921</b>	<b>8,799,514,046</b>	<b>1,430,908,285</b>	<b>406,602</b>	<b>11,431,689,854</b>
<b>Amortizimi i akumuluar</b>						
<b>Më 1 janar 2019</b>	<b>(244,687,308)</b>	<b>(547,074,825)</b>	<b>(4,859,930,198)</b>	-	(212,640)	<b>(5,651,904,971)</b>
Amortizimi për vitin	(15,037,488)	(33,623,064)	(427,479,070)	-	(23,275)	<b>(476,162,897)</b>
Diferenca konvertimi	3,441,444	7,694,420	69,704,073	-	2,977	<b>80,842,914</b>
<b>Më 31 dhjetor 2019</b>	<b>(256,283,352)</b>	<b>(573,003,469)</b>	<b>(5,217,705,195)</b>	-	<b>(232,938)</b>	<b>(6,047,224,954)</b>
Amortizimi për vitin	(15,171,993)	(33,923,812)	(443,858,950)	-	(23,554)	<b>(492,978,309)</b>
Diferenca konvertimi	(3,992,888)	(8,927,395)	(80,634,191)	-	(3,773)	<b>(93,558,247)</b>
<b>Më 31 dhjetor 2020</b>	<b>(275,448,233)</b>	<b>(615,854,676)</b>	<b>(5,742,198,336)</b>	-	<b>(260,265)</b>	<b>(6,633,761,510)</b>
<b>Vlera neto</b>						
<b>Më 31 dhjetor 2019</b>	<b>109,026,648</b>	<b>243,811,304</b>	<b>3,407,857,290</b>	<b>717,428,656</b>	<b>167,320</b>	<b>4,478,291,218</b>
<b>Më 31 dhjetor 2020</b>	<b>95,651,767</b>	<b>213,906,245</b>	<b>3,057,315,710</b>	<b>1,430,908,285</b>	<b>146,337</b>	<b>4,797,928,344</b>

## TIRANA INTERNATIONAL AIRPORT SH.P.K.

### Shënime mbi Pasqyrat Financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020

(të gjitha shumat janë të shprehura në Lek, përveçse kur është shprehur ndryshe)

#### 8. TATIM FITIMI I PARAPAGUAR

Parapagimi i tatim fitimit në shumën 140,222,686 Lek (2019: 50,183,655 Lek) është rezultat i pagesave të bëra nga Shoqëria gjatë vitit 2020 në shumën 231,859,645 Lek (2019: 712,139,278 Lek) minus tatimin mbi fitimin e vitit 2020 në shumën 141,820,614 Lek (2019: 689,450,745 Lek) (shiko gjithashtu shënimin 23) dhe gjendjes së mbartur nga viti i kaluar.

Diferenca prej 823 mijë Lek (2019: 762 mijë Lek) vjen si pasojë e kursit të këmbimit të përdorur për shpenzimin e tatimit mbi fitimin në monedhën funksionale. Më 31 dhjetor 2020 dhe 2019 shumat përkatëse janë të paraqitura në zërin e “Të ardhurave gjithpërfshirëse”.

#### 9. LLOGARI TË ARKËTUESHME, NETO

	<u>31 dhjetor 2020</u>	<u>31 dhjetor 2019</u>
<i>Llogaritë e borxhit me kosto të amortizuar</i>		
Llogari të arkëtueshme nga kompanitë ajrore	2,753,986,308	2,726,157,541
Llogari të tjera të arkëtueshme	81,868,403	45,707,471
	<u>2,835,854,711</u>	<u>2,771,865,012</u>
Minus: Provigjion për llogari të dyshimta	(1,255,170,913)	(1,103,173,963)
<b>Llogari të arkëtueshme, neto</b>	<u><b>1,580,683,798</b></u>	<u><b>1,668,691,049</b></u>

Lëvizja e provigjionit për llogaritë e dyshimta paraqitet si më poshtë:

	<u>2020</u>	<u>2019</u>
Më 1 janar	1,103,173,963	806,873,136
Rritja në provigjion për vitin	134,512,136	307,087,902
Efekti i ndryshimit të kursit të këmbimit	17,484,814	(10,787,075)
<b>Më 31 dhjetor</b>	<u><b>1,255,170,913</b></u>	<u><b>1,103,173,963</b></u>

Më 31 dhjetor 2020, Shoqëria ka njohur një shumë prej 134,512 mijë Lek (2018: 307,088 mijë Lek) si provigjion për llogaritë e dyshimta e përberë nga balanca e mbetur e kompanisë ajrore Ernest S.p.A (35,176 mijë Lek) dhe një provizion për humbjet e pritshme (99,336,310 Lek). Ernest S.p.A ka ndërprerë operimet në janar 2020 pas pezullimit të licensës nga Autoriteti i Aviacionit Civil Italian dhe rreth 80% e balancës së mbetur është provigjionuar në vitin 2019. Manaxhimi i Shoqërisë beson se mundësia e arkëtimit të balancës së mbetur nga kjo kompani ajrore është e ulët dhe ka vendosur të provigjonojë balancën e mbetur në vitin 2020. Për më tepër Shoqëria ka njohur humbje të pritshme të llogaritura sipas metodës së thjeshtëzuar mbi të gjitha llogaritë e arkëtueshme.

Llogaritë e arkëtueshme janë aktive që nuk gjenerojnë interes dhe janë përgjithësisht me parapagim ose kushte pagese të mëvonshme 15 deri në 30 ditë.

Gjendja e mbartur e llogarive të arkëtueshme nga kompanitë ajrore përfshin shumën prej 1,351,16 mijë Lek (2019: 1,428,696 mijë Lek), e cila lidhet me tarifën e kalimit të kufirit (referuar ne Kontratën e Koncesionit si “taksa e kalimit të kufirit”) (shiko shënimin 17) për të cilën Shoqëria ka detyrim t’ia transferojë zyrës së tatimeve pasi ta arkëtojë nga kompanitë ajrore. Shoqëria nuk ka asnjë risk të kredisë nga mbledhshmëria e këtyre balancave, dhe si rrjedhim nuk ka njohur asnjë provigjion.

**TIRANA INTERNATIONAL AIRPORT SH.P.K.****Shënime mbi Pasqyrat Financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020***(të gjitha shumat janë të shprehura në Lek, përveçse kur është shprehur ndryshe)***10. AKTIVE TË TJERA**

Aktive të tjera më 31 dhjetor 2020 detajohen si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2020</u>	<u>31 dhjetor 2019</u>
Parapagim i furnitorëve	782,711,062	3,375,683
TVSH e arkëtueshme	446,488,815	252,268,951
Inventar	18,166,977	16,889,329
Aktive të tjera	6,359,187	20,190,491
Parapagim i taksës së vizës	4,919,281	4,842,529
Interesa të arkëtueshme nga llogari bankare	22,690	22,646
Tatim në burim i parapaguar	3,484,421	-
<b>Totali</b>	<b><u>1,262,152,433</u></b>	<b><u>297,589,629</u></b>

Parapagimi i funitorëve përbëhet kryesisht nga shuma 742,200 mijë Lek parapaguar për Kastrati Group Sh.a. Shoqëria ka lidhur një marrëveshje ndërtimi me Kastrati Group Sh.a. për rehabilitimin e pistës dhe rrugës lidhëse dhe kalimit Whisky si dhe për përmirësimin e rrugës lidhëse Delta. Punët ndërtimore janë planifikuar për të filluar në vitin 2021. Aktive të tjera përfshin shumën prej 6,047 mijë Lek (2019: 5,953 mijë Lek) për t'u arkëtuar nga Ministria e Transportit për dëmtimin e tokës së paditësit gjatë procesit të shpronësimit dhe ndërtimit të rrugës hyrëse. Shuma totale e vlerësuar nga Gjykata për t'iu rimbursuar paditësit është 18,141 mijë Lek (ekuivalente e 146,655 Euro) ku të treja palët e paditura, duke përfshirë Shoqërinë Tirana International Airport Sh.p.k. janë përgjegjës solidarë (detyrim i përbashkët dhe individual). Duke patur parasysh që shuma është paguar e plotë nga Shoqëria, diferenca midis detyrimit total ndaj paditësit dhe pjesës së Shoqërisë është regjistruar si aktive të tjera. Gjithashtu, aktive të tjera përfshin fatura të marra për t'u shpërndarë në periudhat e ardhshme.

**11. PARA NË ARKË DHE BANKË**

Paraja në arkë dhe bankë më 31 dhjetor 2020 paraqitet si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2020</u>	<u>31 dhjetor 2019</u>
Para në arkë		
Në Euro	290,956	179,616
Në Lek	43,618	76,314
	<b><u>334,574</u></b>	<b><u>255,930</u></b>
Para në bankë		
Në Euro	801,785,539	3,014,930,208
Në USD	4,434,273	2,695,754
Në Lek	2,051,041	1,298,989
	<b><u>808,270,853</u></b>	<b><u>3,018,924,951</u></b>
Para e vendosur si garanci në Euro	4,384,820	4,384,820
<b>Totali i parasë në arkë dhe bankë</b>	<b><u>812,990,247</u></b>	<b><u>3,023,565,701</u></b>
Minus: Fonde të ngurtësuar në bankë	-	(1,122,719,400)
<b>Totali i parasë dhe ekuivalentë të saj</b>	<b><u>812,990,247</u></b>	<b><u>1,900,846,301</u></b>

**TIRANA INTERNATIONAL AIRPORT SH.P.K.****Shënime mbi Pasqyrat Financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020***(të gjitha shumat janë të shprehura në Lek, përveçse kur është shprehur ndryshe)***11. PARA NË ARKË DHE BANKË (VAZHDIM)**

Më 31 dhjetor 2020 dhe 2019 paraja në bankë në Euro përfshin llogari rrjedhëse tek Alpha Bank, Bank of China Hungari (2019: Bank of China degë në Britaninë e Madhe) dhe Intesa Sanpaolo Bank për pagesa të lidhura me aktivitetet ditore operationale. Më 31 dhjetor 2019, shuma prej 1,122,719 mijë Lek përfaqëson fonde të ngurtësuara të vendosura në Llogarinë Rezervë të Shërbimit të Borxhit dhe Llogarinë Rezervë për investime Kapitale tek Alpha Bank, siç është kërkuar në seksionin 5.16 (c) të Marrëveshjes së Ndryshuar për Kushtet e Përbashkëta. Duke marrë parasysh, që Shoqëria i ka paguar huatë plotësisht në mars 2020, fondet e ngurtësuara janë çliruar duke përfaqësuar kështu fonde të lira për aktivitetin operacional.

**12. KREDI BANKARE DHE HUA TË TJERA**

Kredi bankare dhe hua të tjera të matura me koston e amortizuar më 31 dhjetor 2020 janë të përbëra si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2020</u>	<u>31 dhjetor 2019</u>
<i>Detyrime financiare me kosto të amortizuar</i>		
<i>Pjesa afatgjatë</i>		
Marrëveshja e Huasë Kryesore (a)	-	594,305,618
Qira financiare (b)	12,455,776	19,962,072
	<u>12,455,776</u>	<u>614,267,690</u>
<i>Pjesa afatshkurtër</i>		
Marrëveshja e Huasë Kryesore (a)	-	561,108,374
Qira financiare (b)	9,886,652	8,971,406
Interes i pagueshëm për kreditë bankare dhe huatë e tjera	-	10,663,856
	<u>9,886,652</u>	<u>580,743,636</u>
<b>Totali</b>	<u><b>22,342,428</b></u>	<u><b>1,195,011,326</b></u>

**(a) Marrëveshja e Huasë Kryesore**

Më datë 23 mars 2005, Shoqëria mori hua në shumën prej 3,032,073 mijë Lek (ekuivalente me 24,900,000 Euro) (Transhi 1), të cilat kanë qenë të disbursuara plotësisht më 31 dhjetor 2019 dhe 2018. Më tej, më datë 28 mars 2008, Shoqëria mori hua të tjera në shumën 2,678,940 mijë Lek (22,000,000 Euro) (Transhi 2), e cila përfaqësonte limitin maksimal të kësaj kredie. Disbursimi aktual është 2,192,718 mijë (18,007,047 Euro) dhe diferenca është anuluar. Transhi 2 është përdorur për financimin e punimeve për zgjerimin e Terminalit të Ri të Pasagjerëve (Faza B). Të dy huatë janë mbledhur në një si dhe rregullohen nga Marrëveshja e Kushteve të Përgjithshme të Ndryshuara dhe Rikonstatuara, nënshkruar më datë 28 mars 2008.

Shoqëria ka paguar plotësisht vlerën e mbetur të huave në mars 2020. Gjendja e mbetur për çdo kredidhënës më datë 31 dhjetor 2020 and 2019 detajohet si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2020</u>	<u>31 dhjetor 2019</u>
Kredi nga BERZH	-	561,901,530
Kredi nga DEG	-	233,737,338
Kredi nga Alpha Bank	-	228,783,234
Kredi nga Intesa Sanpaolo (dikur Banka Amerikane e Shqipërisë (“ABA”))	-	141,640,029
<b>Totali i principalit për t’u paguar</b>	<u><b>-</b></u>	<u><b>1,166,062,131</b></u>

**TIRANA INTERNATIONAL AIRPORT SH.P.K.****Shënime mbi Pasqyrat Financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020***(të gjitha shumat janë të shprehura në Lek, përveçse kur është shprehur ndryshe)***12. KREDI BANKARE DHE HUA TË TJERA (VAZHDIM)****(a) Marrëveshja e Huasë Kryesore (vazhdim)**

Më 31 dhjetor 2019 totali i principalit të mbetur në shumën 3,032,073 mijë Lek (24,900,000 Euro) ka të bëjë me Transhin 1 dhe shuma prej 2,192,718 mijë Lek (18,007,047 Euro) me Transhin 2 (të disbursura), paraqitur neto me shumën e paamortizuar të komisioneve të disbursimit paguar bankave për huatë e marra nga grupi i institucioneve financiare, siç detajohet më poshtë:

	<b>31 dhjetor 2020</b>	<b>31 dhjetor 2019</b>
Principali bruto i Huasë Kryesore	-	1,166,062,132
Komisioni fillestar i paamortizuar i kredisë	-	(10,648,140)
<b>Gjendja sipas kostos së amortizuar</b>	<b>-</b>	<b>1,155,413,992</b>

Data e maturimit të huave është ndryshuar në bazë të Marrëveshjes së Kushteve të Përgjithshme të Ndryshuara dhe Rikonstatuara dhe është shtyrë më datë 15 tetor 2021. Përqindja e interesit është ndryshuar duke filluar nga data 15 prill 2008 në 6 muaj Euribor + marzhin e Bankës (fillimisht e vendosur në nivelin 3%) dhe paguhet çdo gjashtë muaj. Ndryshimi në tarifë është subjekt i arritjes së disa kushteve të përcaktuara në Marrëveshjen e Kushteve të Përgjithshme të Ndryshuara dhe Rikonstatuara. Gjithashtu, si rezultat i vendimit të marrë në Këshillin Administrativ, interesi për kreditë e marra nga BERZH dhe DEG është fiksuar deri në maturimin e këtyre kredive me një normë prej 3.59% dhe 3.55% respektivisht, ndërsa interesi për kreditë e marra nga Alpha Bank dhe Intesa Sanpaolo Bank do të vazhdojë të jetë Euribor 6 mujor plus marzhin e Bankës. Kompensimi i principalit për huatë Transhi 1 ka filluar më datë 15 prill 2008 ndërkohë principalit të Transhi 2 paguhet në këste çdo gjashtë muaj duke filluar nga data 15 prill 2010 deri në datën e maturimit. Huaja është garantuar nga një garanci e mëparshme huaje bazuar në të gjitha aktivet e trupëzuar të Shoqërisë (shih shënimin 6). Megjithatë, duke mbajtur parasysh shlyerjen e plotë të huave në mars 2020, të gjitha asetet e Shoqërisë janë cliruar nga bllokimi.

**(b) Qiratë financiare**

Shoqëria ka hyrë në kontrata qiraje për disa makina në përdorim për punonjësit e saj. Afati i kontratave të qirasë është 4 vjet dhe detyrimi i Shoqërisë për këto qira sigurohet nga titulli i pronësisë së qiradhënësit.

**13. LLOGARI TË PAGUESHME**

	<b>31 dhjetor 2020</b>	<b>31 dhjetor 2019</b>
Furnitorë të tjerë	141,376,829	51,306,520
Furnitorë për ndërtime	63,997,061	176,409,417
Shërbime	30,482,896	31,027,727
Karburante dhe utilitete	16,772,359	21,371,487
Shërbime të sigurisë	4,255,280	3,943,643
Detyrimë të përlllogaritura	2,282,512	5,218,697
Shërbime të tjera aeroportuale	2,028,062	511,434
<b>Totali</b>	<b>261,194,999</b>	<b>289,788,925</b>

Furnitorë të tjerë përfaqësojnë detyrime të Shoqërisë të lidhura me aktivitetin ditor që janë të pagueshme në fillim të vitit 2021.

## **TIRANA INTERNATIONAL AIRPORT SH.P.K.**

### **Shënime mbi Pasqyrat Financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020**

---

*(të gjitha shumat janë të shprehura në Lek, përveçse kur është shprehur ndryshe)*

#### **14. PALË TË LIDHURA**

Nga dhjetor 2020, Kastrati Group sh.a. është ortaku i vetëm i Shoqërisë zotërues i 1 kuote korespondente të 100% te kapitalit ekuivalente me 1,161,148,883 Lek (9,375,000 EUR). Përfituesi përfundimtar i Shoqërisë është Shefqet Kastrati. Më 31 dhjetor 2020 balanca për t'iu paguar Kastrati Group Sh.a. 1,806 mijë Lek and lidhet me detyrimin për faturat e blerjes së karburantit (2019: balanca e mbetur me Real Fortress Privat Limited është 9,562 mijë Lek dhe lidhet vetëm me rimbursimin e kostove të udhëtimit).

Në dhjetor 2020, Shoqëria ka hyrë hyrë në një marrëveshje ndërtimi me Kastrati Group Sh.a. për rehabilitimin e pistës dhe rrugës lidhëse dhe kaluese Whisky si dhe përmirësimin e rrugës lidhëse Delta. Më 31 dhjetor 2020, Shoqëria ka parapaguar tek Kastrati Group Sh.a. për punimet subjekt I kësaj marrëveshje shumë prej 742,200 mijë Lek (ekuivalente të 6,000,000 EUR).

Gjatë vitit 2020, Shoqëria ka kryer shpenzime udhëtimit për aksionarin e mëparshëm në shumë prej 151,652 Lek dhe ka paguar njërin nga anëtarët e Bordit Administrativ në shumë prej 1,101 mijë Lek.

Gjatë vitit 2019, transaksionet me palët e lidhura në shumë prej 12,821 mijë Lek kishin lidhje me kostot e udhëtimit për anëtarët e Bordit Administrativ (11,957 mijë Lek) dhe pagesën e njërit prej anëtarëve të këtij bordi (864 mijë Lek).

Transaksionet e mësipërme janë kryer sipas termave dhe kushteve tregtare me një çmim që i përafrohet tregut.

Shoqëria ka gjithashtu marrëdhënie si palë të lidhura me drejtorët ekzekutivë të saj. Kompensimi për drejtorët ekzekutivë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020, përfshirë në shënimin 20, është 90,012 mijë Lek (2019: 141,444 mijë Lek).

## TIRANA INTERNATIONAL AIRPORT SH.P.K.

### Shënime mbi Pasqyrat Financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020

(të gjitha shumat janë të shprehura në Lek, përveçse kur është shprehur ndryshe)

#### 15. PROVIGJION PËR DETYRIMET KONÇENSIONARE

Shoqëria ka si detyrim të mirëmbajtje pistën e uljes së avionëve sipas Shtojcës Nr. 23 të Kontratës së Koncesionit. Si rezultat i rishikimit të planit të investimeve kapitale në planin afatgjatë të kryer gjatë vitit 2019, Shoqëria ka vlerësuar që shuma e nevojshme për këtë mirëmbajtje është 5.5 milion Euro. Gjatë vitit 2020, Shoqëria ka kryer një rishikim tjetër të vlerës së parashikuar i cili rezultoi në të njëjtin vlerëim me atë të vitit 2019. Më tej, këto punime parashikohet të fillojnë dhe përfundojnë gjatë vitit 2021. Sipas KIRFN 12 *Marrëveshjet Koncesionare të Shërbimit*, ky detyrim kontraktual është njohur dhe matur sipas parimeve të SNK 37 *Provigjionet, Pasivet dhe Aktivitet e Kushtëzuara*, me parashikimin më të mirë të shpenzimit që do të duhej për përmbushjen e detyrimit në datën e raportimit.

	<u>2020</u>	<u>2019</u>
<b>Balanca më 1 janar</b>	676,115,308	<b>586,060,893</b>
Shtesa	-	98,263,262
Rimarrje	-	-
Përdorimi	(8,870,119)	-
Diferenca konvertimi	10,693,522	(8,208,847)
<b>Balanca më 31 dhjetor</b>	<b><u>677,938,711</u></b>	<b><u>676,115,308</u></b>

Gjatë vitit 2020, Shoqëria ka filluar aktivitetin e planifikimit dhe projektimit për rehabilitimin e pistës dhe punimeve të tjera për të cilat është krijuar ky fond.

#### 16. TARIFA E PAGUESHME E KONCESIONIT

Siç është detajuar tek Shënimi 1 i pasqyrave financiare, bazuar në marrëveshjen e koncesionit, Shoqëria ka detyrim kontraktual t'i paguajë Qeverisë së Shqipërisë 30% të Fitimit të Shpërndashëm referuar si "Kuota Junior" (referencë neni 20c dhe skeduli 43 i Kontratës së Koncesionit). Mbështetur në këtë kontratë, Shoqëria nuk është e detyruar të paguajë këtë shumë nëse pagesa e një shume të tillë është e kufizuar nga Dokumentat e Financimit me Huadhënësit Kryesorë ose Huadhënësit e Nënrenditur. Në këtë rast, gjatë kësaj periudhe, Shoqëria duhet të akumulojë shumën dhe kjo vlerë e akumuluar duhet të njihet si e pagueshme ndaj Qeverisë së Shqipërisë siç parashikohet në Kontratën e Koncesionit.

Gjatë vitit 2020, nisur nga situata e pandemisë krijuar nga Covid-19, Shoqëria përdori nenin 23 (iv) të kontratës së koncesionit *Rastet e Clirimit nga Përgjegjësia* për të shtyrë pagesën e detyrimit të tarifës së koncesionit nga Qeverisë Shqiptare në shumën prej EUR 6,139,042 euro. Për rrjedhojë, detyrimi i akumuluar në 31 dhjetor 2020 përbëhet nga detyrimet respektive të viteve 2019 (6,139,042 Euro) dhe 2020 (1,031,253 Euro)



**TIRANA INTERNATIONAL AIRPORT SH.P.K.****Shënime mbi Pasqyrat Financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020***(të gjitha shumat janë të shprehura në Lek, përveçse kur është shprehur ndryshe)***17. DETYRIME TË TJERA**

Detyrime të tjera më 31 dhjetor 2020 janë të përbëra si më poshtë:

	<b>31 dhjetor 2020</b>	<b>31 dhjetor 2019</b>
<i>Pjesa afatshkurtër</i>		
Tarifa e kalimit të kufirit (a)	1,373,520,127	1,428,695,611
Detyrime të tjera (b)	-	154,761,876
Shuma e borxhit të mëparshëm – pjesa afatshkurtër (c)	41,927,521	44,667,464
Detyrime ndaj personelit (d)	20,238,062	132,655,101
Tarifa e sigurisë (e)	9,732,872	15,522,054
Të tjera taksa të pagueshme	23,365,527	18,828,340
Detyrimi për tatimin në burim	-	280,693
Të tjera	229,600	352,340
	<b>1,469,013,709</b>	<b>1,795,763,479</b>
<i>Pjesa afatgjatë</i>		
Shuma e borxhit të mëparshëm – pjesa afatgjatë (c)	138,159,801	177,277,566
<b>Totali</b>	<b>1,607,173,510</b>	<b>1,973,041,045</b>

**(a) Tarifa e kalimit të kufirit**

Tarifa e kalimit të kufirit përfaqëson shumën të paguar nga çdo pasagjer që kalon nga aeroporti. Shoqëria i mbledh këto taksa nga kompanitë ajrore për llogaritë të autoriteteve shqiptare të taksave. Tarifa është e pagueshme menjëherë me arkëtimin nga kompanitë ajrore.

**(b) Detyrime të tjera**

Të ardhura të shtyra janë para të mara në avancë nga disa kompani ajrore të cilat kanë një marrëdhënie kontraktuale me Shoqërinë për të parapaguar fluturimet e ardhshme. Të ardhurat e shtyra më 31 dhjetor 2019 përfaqësojnë para të mara në avancë për fluturimet që do të ndodhin gjatë muajit janar 2020. Shuma më 31 dhjetor 2019 përbëhet kryesisht nga para të mara në avancë nga kompanitë Blue Panorama dhe Alitalia. Duke patur parasysh situatën e pandemisë të krijuar nga Covid-19, kompanitë ajrore u lejuan të operonin nën kushtet e paspagimit dhe për rrjedhojë nuk kishte parapagime domethënëse prej këtyre kompanive.

**(c) Shuma e borxhit të mëparshëm**

Shuma e borxhit të mëparshëm paraqet një kredi të mëparshme që Kreditanstalt für Wiederaufbau (“KfW”) i ka akorduar Qeverisë së Shqipërisë, kredi e cila do të paguhet nga Shoqëria gjatë periudhës së koncensionit në përputhje me skedulën 4 të kontratës së koncensionit. Detyrimi është i pagueshëm sipas skedulit të dhënë nga Qeveria e Shqipërisë, megjithatë interesi dhe princiali nuk janë të identifikuar më vete për çdo kësht. Si rrjedhim, vlera e drejtë e kredisë është konsideruar vlera aktuale e pagesave të shtyra, e cila është e llogaritur duke skontuar të gjitha pagesat e ardhshme duke përdorur një normë interesi 7.5%, që përfaqëson normën e huamarrjes afatgjatë të Shoqërisë. Pas njohjes fillestare, borxhi i mëparshëm matet me koston e amortizueshme. Data e maturimit e detyrimit është 15 dhjetor 2025 dhe princiali është i pagueshëm me kështë gjashtëmujore.

**(d) Detyrime ndaj personelit**

Shuma e detyrimit ndaj personelit përfaqëson pjesërisht detyrimin për pagën e dhjetorit 2020 e paguar në fillim të janarit 2021. Gjithashtu, balanca më 31 dhjetor 2019 përfshin vlerën e llogaritur të bonusit të punonjësve për t’u shpërndarë në vitin 2020.

**(e) Tarifa e sigurisë**

Në përputhje me detyrimin për të mbuluar shërbimin mbi sigurinë, Shoqëria ka të drejtë të mbledhë nga çdo pasagjer që përdor aeroportin një tarifë sigurie prej 4 Euro për çdo pasagjer në nisje, që të mbulojë shpenzimet e arsyeshme për dhënie të këtij shërbimi. Shoqëria do t’i paguajë Autoritetit Shqiptar të Aviaionit Civil 25% të tarifës së mbledhur në baza mujore me vonesë dhe do të ketë të drejtë të mbajë diferencën.

## TIRANA INTERNATIONAL AIRPORT SH.P.K.

### Shënime mbi Pasqyrat Financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020

(të gjitha shumat janë të shprehura në Lek, përveçse kur është shprehur ndryshe)

#### 18. KAPITALI THEMELTAR

Bazuar në vendimin e ortakëve të datës 25 maj 2005 dhe në përputhje me marrëveshjen e financimit të ortakëve datë 5 shkurt 2005, kapitali i nënshkruar më 31 dhjetor 2020 dhe 2019 është 1,161,148,883 Lek (9,375,000 Euro). Në mbledhjen e jashtëzakonshme të Asamblesë së ortakëve të Shoqërisë, të mbajtur më 6 tetor 2016, ortakët e saj aprovuan njëzëri shitjen dhe transferimin e kuotave të tyre tek ortaku i ri dhe i vetëm Real Fortress Private Limited. Më vonë, gjatë dhjetorit 2020, aksionari i vetëm i Shoqërisë vendosi shitjen dhe transferimin e kuotave të aksionari i ri Kastrati Group Sh.a. Nga data dhjetori 2020, Kastrati Group Sh.a. është ortaku i vetëm i Shoqërisë zotërues i 1 kuote korespondente të 100% të kapitalit ekuivalente me 1,161,148,883 Lek (9,375,000 EUR). Gjatë vitit 2020, Shoqëria ka deklaruar një dividend në shumën 621,600 mijë Lek (ekuivalente me 5,000 mijë Euro) (2019: 999,680 mijë Lek ekuivalente me 8,000 mijë Euro), bazuar në vendimin e Asamblesë datë 23 prill 2020 (në vitin 2019 dividenti është deklaruar dhe paguar brenda vitit).

#### 19. TË ARDHURA

Të ardhurat e njohura për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020 përbëhen si më poshtë:

	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2020	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2019
Të ardhura nga aviacioni	2,972,696,428	6,439,116,969
Shitje	51,367,336	176,134,174
Tarifa qiraje	132,489,183	194,243,769
Komisioni nga transaksionet si Agjent	43,205,355	98,489,213
Reklama	31,517,264	45,839,815
Të ardhura të tjera	2,750,676	7,244,659
<b>Totali</b>	<b>3,234,026,242</b>	<b>6,961,068,599</b>

Të ardhurat nga shitja përfaqësojnë të ardhura të gjeneruara nga aktiviteti i dhënies me qera të dyqaneve të shitjes me pakicë, bareve dhe restoranteve dhe biznesi i duty free. Tarifat e qirave paraqesin të ardhura nga dhënia me qira e dyqaneve dhe zyra të ndryshme që ndodhen në zonën e terminalit të ri si dhe të ardhura të tjera nga aktivitetet jo aeronautike si karburanti dhe parkimi. Të gjitha kontratat e qirave janë në Euro. Të ardhura të tjera përfshijnë kryesisht të ardhurat nga komisioni i agjentit të lidhur me tarifën e kalimit të kufirit. Bazuar në udhëzimin e ri mbi tarifën e kalimit të kufirit në fuqi nga data 1 tetor 2014, Shoqëria ka të drejtën të mbaje 5% të shumës së arkëtuar nga kompanitë ajrore dhe të transferuar në autoritetin e taksave.

#### Rezultati neto nga shërbimet e ndërtimit të infrastrukturës së koncesionit (IFRIC 12)

	Year ended December 31, 2020	Year ended December 31, 2019
Shërbime ndërtimi të infrastrukturës së koncesionit	740,973,973	749,025,109
Kosto ndërtimi të infrastrukturës së koncesionit	(740,973,973)	(749,025,109)
<b>Rezultati neto nga shërbimet e ndërtimit</b>	<b>-</b>	<b>-</b>

Në përputhje me KIRFN 12, Shoqëria njeh të ardhurat dhe kostot nga shërbimet e ndërtimit në lidhje me aktivin jomaterial dhe shërbimet e përmirësimit të ndërtuara gjatë periudhës së koncesionit. Të ardhurat dhe kostot për ofrimin e shërbimeve operative njihen gjatë afatit të marrëveshjes së koncesionit. Shoqëria nuk përfiton asnjë fitim mbi shërbimet e ndërtimit dhe përmirësimit të infrastrukturës. Këto shërbime dhe kosto janë njohur vetëm për përputhshmërinë me kërkesat e KIRFN 12 dhe nuk kanë asnjë ndikim në fitimin neto të Shoqërisë.

**TIRANA INTERNATIONAL AIRPORT SH.P.K.****Shënime mbi Pasqyrat Financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020***(të gjitha shumat janë të shprehura në Lek, përveçse kur është shprehur ndryshe)***19. TË ARDHURA (VAZHDIM)****19.1 Informacion i zbërthyer i të ardhurave**

Më poshtë paraqitet informacioni i zbërthyer i të ardhurave të Shoqërisë nga kontratat me konsumatorët:

	<b>Të ardhura nga aviacioni</b>	<b>Shitje</b>	<b>Tarifa qiraje</b>	<b>Komisioni nga transaksionet si Agjent</b>	<b>Reklama</b>	<b>Të ardhura të tjera</b>	<b>Totali</b>
<b>Llojet e shërbimit</b>							
Pasagjerët	919,848,362	-	-	-	-	-	<b>919,848,362</b>
Shërbimet në tokë	1,081,621,525	-	-	-	-	-	<b>1,081,621,525</b>
Ulje-ngritjet	517,018,514	-	-	-	-	-	<b>517,018,514</b>
Siguria	236,525,179	-	-	-	-	-	<b>236,525,179</b>
Ndricimi	123,758,302	-	-	-	-	-	<b>123,758,302</b>
Shitje	-	51,367,336	-	-	-	-	<b>51,367,336</b>
Tarifa qeraje	-	-	132,489,183	-	-	-	<b>132,489,183</b>
Komisioni nga transaksionet si Agjent	-	-	-	43,205,355	-	-	<b>43,205,355</b>
Kargo	33,200,378	-	-	-	-	-	<b>33,200,378</b>
Parkim	60,243,825	-	-	-	-	-	<b>60,243,825</b>
Reklama	-	-	-	-	31,517,264	-	<b>31,517,264</b>
Të tjera aeroportuale	480,343	-	-	-	-	-	<b>480,343</b>
Të tjera	-	-	-	-	-	2,750,676	<b>2,750,676</b>
	<b>2,972,696,428</b>	<b>51,367,336</b>	<b>132,489,183</b>	<b>43,205,355</b>	<b>31,517,264</b>	<b>2,750,676</b>	<b>3,234,026,242</b>
<b>Koha e njohjes të të ardhurës</b>							
Transferimi në një moment të caktuar	<b>2,972,696,428</b>	<b>51,367,336</b>	<b>132,489,183</b>	<b>43,205,355</b>	<b>31,517,264</b>	<b>2,750,676</b>	<b>3,234,026,242</b>
Transferimi përgjatë kohës	-	-	-	-	-	-	-

**TIRANA INTERNATIONAL AIRPORT SH.P.K.****Shënime mbi Pasqyrat Financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020***(të gjitha shumat janë të shprehura në Lek, përveçse kur është shprehur ndryshe)***20. SHPENZIME PERSONELI**

Shpenzime personeli si dhe shpenzimet e lidhura me to për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020 janë si më poshtë:

	<u>Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2020</u>	<u>Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2019</u>
Paga	678,686,190	756,906,259
Sigurime shoqërore dhe tatim mbi të ardhurat	90,641,779	84,791,895
Udhëtime dhe trajnime	48,580,501	66,769,642
Punonjës me kontratë shërbimi	480,000	480,000
Shpenzime të tjera	780,000	18,664
<b>Totali</b>	<b>819,168,470</b>	<b>908,966,460</b>

**21. SHPENZIME TË PËRGJITHSHME DHE ADMINISTRATIVE**

Shpenzimet e përgjithshme dhe administrative për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020 janë si më poshtë:

	<u>Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2020</u>	<u>Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2019</u>
Shërbime sigurimi	21,373,718	193,134,613
Shërbime mirëmbajtje	236,525,473	233,787,743
Shërbime të ofruara	210,331,532	74,376,177
(Rimarrje)/Provigjone për llogari të dyshimta	134,512,136	307,087,902
Karburante dhe të tjera	116,581,265	154,188,984
Materiale	57,213,563	54,756,549
Përfaqësime dhe reklama	55,321,601	157,478,209
Komisione dhe taksa të tjera	33,375,538	32,808,515
Shërbime aviacioni	32,365,570	63,777,516
Siguracion	31,494,114	28,296,421
Shpenzime transporti	13,266,248	12,819,226
Komunikim	6,318,566	6,395,936
Humbje nga nxjerrja jashtë përdorimit e aktiveve të trupëzuara	3,811,172	3,910,434
Qira operacionale dhe financiare	2,804,348	3,373,738
<b>Totali</b>	<b>955,294,844</b>	<b>1,326,191,963</b>

Shoqëria ka një marrëveshje kontraktuale me Shoqërinë Audituese për auditimin e pasqyrave financiare. Pagesa vjetore e përfshirë në zërin Shërbime të ofruara është 1,921,529 Lek.

**TIRANA INTERNATIONAL AIRPORT SH.P.K.****Shënime mbi Pasqyrat Financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020***(të gjitha shumat janë të shprehura në Lek, përveçse kur është shprehur ndryshe)***22. SHPENZIME FINANCIARE, NETO**

Shpenzimet dhe të ardhurat financiare neto për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020 janë si më poshtë:

	<b>Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2020</b>	<b>Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2019</b>
<i>Shpenzime financiare</i>		
Shpenzime interesi për kreditë afatgjata	(117,814,675)	(161,292,180)
Shpenzime interesi për mbylljen parakohe të kredive	(34,503,958)	-
Shpenzime interesi për huanë financiare	(1,062,013)	(847,576)
Humbje nga konvertimi	(12,853,685)	(19,844,252)
Komisione bankare	(3,609,410)	(3,553,470)
	<b>(169,843,741)</b>	<b>(185,537,478)</b>
<i>Të ardhura financiare</i>		
Të ardhura nga konvertimi	1,953,330.00	15,701,850
Të ardhura nga interesi	1,259,260	3,694,847
	<b>3,212,590</b>	<b>19,396,697</b>
<b>Shpenzime financiare, neto</b>	<b>(166,631,151)</b>	<b>(166,140,781)</b>

**23. TATIMI MBI FITIMIN****23.1 Tatimi i shtyrë aktiv dhe pasiv**

Më 31 dhjetor 2020 tatimi i shtyrë aktiv dhe pasiv vijnë nga zërat e mëposhtëm:

	<b>31 dhjetor 2020</b>	<b>31 dhjetor 2019</b>	<b>E ardhur nga tatimi i shtyrë</b>
<i>Tatimi i shtyrë aktiv</i>			
Provizgjone për llogari të dyshimta të pa njohura për qëllime fiskale	180,708,06	170,884,624	9,823,440
Provizgjone dhe detyrime të tjera	84,886,288	105,370,456	(20,484,168)
Aktive afatgjata	149,156,219	104,027,115	45,129,104
<b>Tatimi i shtyrë aktiv</b>	<b>414,750,571</b>	<b>380,282,195</b>	<b>34,468,376</b>

Shoqëria ka njohur tatim të shtyrë aktiv në lidhje me provizgjonet për llogaritë e dyshimta, të cilat nuk janë ende të zbritshme për qëllime fiskale. Këto balanca do të njihen si të zbritshme vetëm në momentin e fshirjes nga librat kontabël të këtyre vlerave të pambledhshme dhe nëse plotësojnë të gjitha kushtet sipas legjislacionit fiskal, për të cilat manaxhimi beson se do të përmbushen.

Tatimi i shtyrë mbi “Provizgjone dhe detyrime të tjera” ka të bëjë kryesisht me detyrimet për provizgjonet koncesionare, të cilat do të jenë të zbritshme në momentin që do të realizohen.

Tatimi i shtyrë mbi aktivet afatgjata ka të bëjë me normat e ndryshme të amortizimit të aplikuar për qëllime kontabile dhe fiskale. Norma e aplikueshme e taksës për qëllim të llogaritjes së tatimit të shtyrë është 15%.

Lëvizja në tatimin e shtyrë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020 është si më poshtë:

	<b>2020</b>	<b>2019</b>
Më 1 janar	380,282,195	284,557,893
<i>Tatimi i shtyrë</i>	28,602,306	99,111,028
<i>Diferenca konvertimi</i>	5,866,069	(3,386,726)
<b>Ndryshimi neto i të ardhurës nga tatimi i shtyrë</b>	<b>34,468,376</b>	<b>95,724,302</b>
<b>Më 31 dhjetor</b>	<b>414,750,570</b>	<b>380,282,195</b>

**TIRANA INTERNATIONAL AIRPORT SH.P.K.****Shënime mbi Pasqyrat Financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020***(të gjitha shumat janë të shprehura në Lek, përveçse kur është shprehur ndryshe)***23. TATIMI MBI FITIMIN (VAZHDIM)****23.2 Shpenzimi i tatimit mbi fitimin**

Shpenzimi i tatimit mbi fitimin për periudhën e treguar përbëhet si më poshtë:

	<u>Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2020</u>	<u>Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2019</u>
Shpenzimi i tatimit mbi fitimin	141,820,614	689,450,745
Lëvizja në tatimin e shtyrë (shënimi 23.1)	<u>(28,602,306)</u>	<u>(99,111,028)</u>
<b>Shpenzimi i tatimit për vitin</b>	<b><u>113,218,308</u></b>	<b><u>590,339,717</u></b>

Rakordimi midis normës efektive të tatimit dhe normës së përdorur për llogaritjen e fitimit për qëllime fiskale është paraqitur më poshtë:

	<u>Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2020</u>		<u>Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2019</u>	
	<u>Norma efektive</u>		<u>Norma efektive</u>	
<b>Fitimi para tatimit</b>		<b>528,422,858</b>		<b>3,107,524,932</b>
Taksa me normën 15% (2019: 15%)	15.00%	79,263,429	15.00%	466,128,740
Efekti i shpenzimeve të panjohura	6.43%	33,954,879	4.00%	124,210,977
<b>Shpenzimi i tatimit mbi fitimin për vitin</b>		<b><u>21.43%</u>    <b>113,218,308</b></b>		<b><u>19.00%</u>    <b>590,339,717</b></b>

Një rakordim midis fitimit kontabël para llogaritjes së taksës dhe bazës për llogaritjen e tatimit mbi fitimin për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020 është paraqitur si më poshtë:

	<u>Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2020</u>	<u>Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2019</u>
<b>Fitimi para tatimit</b>	<b>528,422,858</b>	<b>3,107,524,932</b>
<i>Plus: Rregullimet për qëllime kontabël:</i>		
Shpenzime të përlllogaritura për personelin sipas SNRF	(112,030,126)	26,354,402
Provizjone për llogari të dyshimta	134,512,136	307,087,902
Provizjone për detyrime koncesionare	-	98,263,262
Diferenca në normat dhe metodën e zhvlerësimit	218,422,917	192,508,858
Shpenzime të përlllogaritura	(50,450,485)	36,056,864
Të tjera	227,602	468,902
<b>Fitimi fiskal para tatimit</b>	<b><u>719,104,902</u></b>	<b><u>3,768,265,122</u></b>
<i>Shpenzime të pazbritshme:</i>		
Tarifa e koncensionit	124,561,365	755,155,565
Shpenzime të tjera të pazbritshme	88,202,256	63,220,141
Gjoha dhe penalitete	4,644,429	2,938,231
Humbje nga nxjerrja jashtë përdorimit	8,957,808	6,759,244
<b>Fitimi i tatueshëm</b>	<b><u>945,470,760</u></b>	<b><u>4,596,338,303</u></b>
<b>Tatimi mbi fitimin 15% (2019: 15%)</b>	<b><u>141,820,614</u></b>	<b><u>689,450,745</u></b>

**TIRANA INTERNATIONAL AIRPORT SH.P.K.****Shënime mbi Pasqyrat Financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020***(të gjitha shumat janë të shprehura në Lek, përveçse kur është shprehur ndryshe)***24. INSTRUMENTAT FINANCIARË****24.1 Rreziku i kredisë**

Analiza e zhvlerësimit bëhet në cdo datë raportimi duke përdorur matricën e provigjonit për të matur humbjet e pritshme. Normat e provigjonit bazohen në ditët me vonesë sipas grupimeve të segmenteve të konsumatorëve të ndryshëm me tiparë të ngjashme të vonesave (p.sh. sipas pozicionit gjeografik, tipit të shërbimit, tipit dhe renditjes së konsumatorit dhe formave të tjera të sigurimit të balancave të pashlyera). Llogaritja paraqet rezultatin e ponderuar me probabilitetin, vlerën në kohë të parasë dhe informacione të arsyeshme dhe të dokumentueshme të cilat janë të vlefshme në datën e raportimit rreth ngjarjeve të shkuara, kushteve të tanishme dhe parashikimeve të kushteve ekonomike të ardhshme. Përgjithësisht, llogaritë e arkëtueshme hiqen nga librat kontabël nëse janë me vonesë për më shumë se një vit dhe nuk janë subjekt i përbushjes së detyrimit me forcë. Ekspozimi maksimal ndaj riskut të kredisë në datën e raportimit, është vlera e mbartur e secilës nga kategoritë të aktiveve financiare të paraqitura në notën 24.1. Shoqëria nuk mban kolateral për të siguruar ekspozimin. Parapagimet nga klientët konsiderohen pjesë përbërëse e llogarive të arkëtueshme dhe merren parasysh në llogaritjen e zhvlerësimit. Shoqëria vlerëson përqëndrimin e riskut të llogarive të arkëtueshme të ulët duke qenë se klientët e saj janë të regjistruar në juridiksione të ndryshme dhe operojnë në tregje rrënjësisht të pavaruar nga njëri-tjetri.

Llogaritë e arkëtueshme sipas vjetërsisë më 31 dhjetor 2020 dhe 2019 janë si më poshtë:

**31 dhjetor 2020**

	Totali	Pa vonesë dhe të pa provigjonuara	Me vonesë por jo të provigjonuara				Me vonesë dhe të provigjonuara
			<30 ditë	31-60 ditë	61-90 ditë	>90 ditë	
<b>2020</b>	2,835,854,711	1,490,523,026	39,989,983	23,191,523	17,120,327	9,858,939	1,255,170,913
<b>Provigjon</b>	(1,255,170,913)						(1,255,170,913)
<b>Balanca e mbartur</b>	<b>1,580,683,798</b>	1,490,523,026	39,989,983	23,191,523	17,120,327	9,858,939	-

**31 dhjetor 2019**

	Totali	Pa vonesë dhe të pa provigjonuara	Me vonesë por jo të provigjonuara				Me vonesë dhe të provigjonuara
			<30 ditë	31-60 ditë	61-90 ditë	>90 ditë	
<b>2019</b>	2,771,865,012	1,450,668,294	186,973,938	31,048,817	-	-	1,103,173,963
<b>Provigjon</b>	(1,103,173,963)						(1,103,173,963)
<b>Balanca e mbartur</b>	<b>1,668,691,049</b>	1,450,668,294	186,973,938	31,048,817	-	-	-

Balanca e mbartur më 31 dhjetor 2020, e prezantuar nën kolonën “Pa vonesë dhe të pa provigjonuara” përfshin një shumë prej 1,351,163 mijë Lek (2019: 1,428,696 mijë Lek) që ka lidhje me tarifën e kalimit të kufirit për të cilën Shoqëria nuk mbart riskun e kredisë.

*Ekspozimi ndaj rrezikut të kredisë:*

Vlera e mbartur e aktiveve financiare paraqet maksimumin e ekspozimit ndaj rrezikut të kredisë. Maksimumi i ekspozimit ndaj rrezikut të kredisë më 31 dhjetor 2020 është paraqitur më poshtë:

	<b>31 dhjetor 2020</b>	<b>31 dhjetor 2019</b>
Para në arkë dhe në bankë	812,655,673	3,023,309,771
Llogari të arkëtueshme, neto	1,580,683,798	1,668,691,049
Aktive të tjera	452,870,692	272,482,088
<b>Totali</b>	<b>2,846,210,163</b>	<b>4,964,482,908</b>

**TIRANA INTERNATIONAL AIRPORT SH.P.K.****Shënime mbi Pasqyrat Financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020***(të gjitha shumat janë të shprehura në Lek, përveçse kur është shprehur ndryshe)***24. INSTRUMENTAT FINANCIARË (VAZHDIM)****24.1 Rreziku i kredisë (vazhdim)***Ekspozimi ndaj rrezikut të kredisë (vazhdim):*

Ekspozimi maksimal i rrezikut të kredisë për llogaritë e arkëtueshme më 31 dhjetor 2020 sipas zonës gjeografike është:

	<b>31 dhjetor 2020</b>	<b>31 dhjetor 2019</b>
Vendas	871,982,815	1,218,525,479
Të huaj	708,700,983	450,165,570
<b>Totali</b>	<b>1,580,683,798</b>	<b>1,668,691,049</b>

Ekspozimi ndaj rrezikut të kredisë në datën e raportimit lidhet kryesisht me klientët për shërbime aeronautike dhe vetëm një shumë e vogël ka të bëjë me klientët tregtarë.



**TIRANA INTERNATIONAL AIRPORT SH.P.K.****Shënime mbi Pasqyrat Financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020***(të gjitha shumat janë të shprehura në Lek, përveçse kur është shprehur ndryshe)***24. INSTRUMENTAT FINANCIARË (VAZHDIM)****24.2 Rreziku i likuiditetit**

Aktivet dhe detyrimet financiare, duke përfshirë pagesat e interesit më 31 dhjetor 2020, sipas maturitetit kontraktual janë detajuar më poshtë:

	<b>Më pak se 6 muaj</b>	<b>6 deri në 12 muaj</b>	<b>Më shumë se një vit</b>	<b>Të tjera</b>	<b>Totali</b>
<b>Aktive financiare</b>					
Llogari të arkëtueshme, neto	229,521,144	-	-	1,351,162,654	<b>1,580,683,798</b>
Aktive të tjera	452,870,692	-	-	-	<b>452,870,692</b>
Para në arkë dhe bankë	812,990,247	-	-	-	<b>812,990,247</b>
<b>Totali i aktiveve financiare</b>	<b>1,495,382,083</b>	<b>-</b>	<b>-</b>	<b>1,351,162,654</b>	<b>2,846,544,737</b>
<b>Detyrime financiare</b>					
Kredi bankare dhe hua të tjera	4,943,299	4,943,299	12,455,830	-	<b>22,342,428</b>
Detyrime të tjera	74,532,095	20,963,810	627,791,354	1,373,520,144	<b>2,096,807,403</b>
Llogari të pagueshme	261,194,999	-	-	-	<b>261,194,999</b>
Divident i pagueshëm	-	587,575,000	-	-	<b>-</b>
Tarifa e pagueshme e koncensionit	886,965,492	-	-	-	<b>886,965,492</b>
<b>Totali i detyrimeve financiare</b>	<b>1,227,635,885</b>	<b>613,482,109</b>	<b>640,247,184</b>	<b>1,373,520,144</b>	<b>3,267,310,322</b>
<b>Hendeku i likuiditetit</b>	<b>267,746,198</b>	<b>(613,482,109)</b>	<b>(640,247,184)</b>	<b>(22,357,490)</b>	<b>(420,765,585)</b>
<b>Hendeku kumulativ</b>	<b>267,746,198</b>	<b>(345,735,911)</b>	<b>(985,983,095)</b>	<b>(1,008,340,585)</b>	<b>-</b>

Zëri “të tjera” përfaqëson balancën e tarifës së kalimit të kufirit, sic paraqitet në shënimet 9 dhe 17, e cila nuk ndikon në hendekun e likuiditetit të Shoqërisë.

**TIRANA INTERNATIONAL AIRPORT SH.P.K.****Shënime mbi Pasqyrat Financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020***(të gjitha shumat janë të shprehura në Lek, përveçse kur është shprehur ndryshe)***24. INSTRUMENTAT FINANCIARË (VAZHDIM)****24.2 Rreziku i likuiditetit**

Aktivet dhe detyrimet financiare, duke përfshirë pagesat e interesit më 31 dhjetor 2019, sipas maturitetit kontraktual janë detajuar më poshtë:

	<b>Më pak se 6 muaj</b>	<b>6 deri në 12 muaj</b>	<b>Më shumë se një vit</b>	<b>Të tjera</b>	<b>Totali</b>
<b>Aktive financiare</b>					
Llogari të arkëtueshme, neto	239,995,397	-	-	1,428,695,652	<b>1,668,691,049</b>
Aktive të tjera	272,482,088	-	-	-	<b>272,482,088</b>
Para në arkë dhe bankë	3,023,565,701	-	-	-	<b>3,023,565,701</b>
<b>Totali i aktiveve financiare</b>	<b>3,536,043,186</b>	-	-	<b>1,428,695,652</b>	<b>4,964,738,838</b>
<b>Detyrime financiare</b>					
Kredi bankare dhe hua të tjera	321,047,823	304,286,304	633,918,564	-	<b>1,259,252,691</b>
Detyrime të tjera	189,974,108	22,333,714	749,153,029	1,428,695,628	<b>2,390,156,479</b>
Llogari të pagueshme	289,788,925	-	-	-	<b>289,788,925</b>
Tarifa e pagueshme e koncensionit	747,551,144	-	-	-	<b>747,551,144</b>
<b>Totali i detyrimeve financiare</b>	<b>1,548,362,000</b>	<b>326,620,018</b>	<b>1,383,071,593</b>	<b>1,428,695,628</b>	<b>4,686,749,239</b>
<b>Hendeku i likuiditetit</b>	<b>1,987,681,186</b>	<b>(326,620,018)</b>	<b>(1,383,071,593)</b>	<b>24</b>	<b>277,989,599</b>
<b>Hendeku kumulativ</b>	<b>1,987,681,186</b>	<b>1,661,061,168</b>	<b>277,989,575</b>	<b>277,989,599</b>	<b>-</b>

Zëri “të tjera” përfaqëson balancën e tarifës së kalimit të kufirit, sic paraqitet në shënimet 9 dhe 17, e cila nuk ndikon në hendekun e likuiditetit të Shoqërisë.

**TIRANA INTERNATIONAL AIRPORT SH.P.K.****Shënime mbi Pasqyrat Financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020***(të gjitha shumat janë të shprehura në Lek, përveçse kur është shprehur ndryshe)***24. INSTRUMENTAT FINANCIARË (VAZHDIM)****24.3 Rreziku i kursit të këmbimit**

Ekspozimi i Shoqërisë ndaj rrezikut të kursit të këmbimit më 31 dhjetor 2020 është si më poshtë:

	<b>Euro</b>	<b>USD</b>	<b>Lek</b>	<b>Vlera kontabël</b>
Llogari të arkëtueshme, neto	1,580,683,798	-	-	<b>1,580,683,798</b>
Aktive të tjera	22,690	-	456,332,423	<b>456,355,113</b>
Para në arkë dhe bankë	802,076,490	4,434,274	6,479,483	<b>812,990,247</b>
<b>Totali i aktiveve monetare</b>	<b>2,382,782,978</b>	<b>4,434,274</b>	<b>462,811,906</b>	<b>2,850,029,158</b>
Kredi bankare dhe hua të tjera	22,342,428	-	-	<b>22,342,428</b>
Llogari të pagueshme	40,470,213	-	220,724,786	<b>261,194,999</b>
Tarifa e pagueshme e koncensionit	886,965,492	-	-	<b>886,965,492</b>
Divident i pagueshëm	587,575,000	-	-	-
Detyrime të tjera	1,563,572,206	-	43,601,304	<b>1,607,173,510</b>
<b>Totali i detyrimeve monetare</b>	<b>3,100,925,339</b>	-	<b>264,326,090</b>	<b>2,777,676,429</b>
<b>Ekspozimi neto</b>	<b>(718,142,361)</b>	<b>4,434,274</b>	<b>198,485,816</b>	<b>72,352,729</b>

**TIRANA INTERNATIONAL AIRPORT SH.P.K.****Shënime mbi Pasqyrat Financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020***(të gjitha shumat janë të shprehura në Lek, përveçse kur është shprehur ndryshe)***24. INSTRUMENTAT FINANCIARË (VAZHDIM)****24.3 Rreziku i kursit të këmbimit (vazhdim)**

Ekspozimi i Shoqërisë ndaj rrezikut të kursit të këmbimit më 31 dhjetor 2019 është si më poshtë:

	<b>Euro</b>	<b>USD</b>	<b>Lek</b>	<b>Vlera kontabël</b>
Llogari të arkëtueshme, neto	1,668,691,049	-	-	<b>1,668,691,049</b>
Aktive të tjera	22,649	-	272,459,439	<b>272,482,088</b>
Para në arkë dhe bankë	3,015,109,824	2,695,754	5,760,123	<b>3,023,565,701</b>
<b>Totali i aktiveve monetare</b>	<b>4,683,823,522</b>	<b>2,695,754</b>	<b>278,219,562</b>	<b>4,964,738,838</b>
Kredi bankare dhe hua të tjera	1,195,011,326	-	-	<b>1,195,011,326</b>
Llogari të pagueshme	44,715,411	-	245,073,514	<b>289,788,925</b>
Tarifa e pagueshme e koncensionit	747,551,144	-	-	<b>747,551,144</b>
Detyrime të tjera	1,666,797,502	-	151,481,667	<b>1,818,279,169</b>
<b>Totali i detyrimeve monetare</b>	<b>3,654,075,383</b>	<b>-</b>	<b>396,555,181</b>	<b>4,050,630,564</b>
<b>Ekspozimi neto</b>	<b>1,029,748,139</b>	<b>2,695,754</b>	<b>(118,335,619)</b>	<b>914,108,274</b>

**TIRANA INTERNATIONAL AIRPORT SH.P.K.****Shënime mbi Pasqyrat Financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020***(të gjitha shumat janë të shprehura në Lek, përveçse kur është shprehur ndryshe)***24. INSTRUMENTAT FINANCIARË (VAZHDIM)****24.4 Rreziku ndaj normës së interesit**

Në datën e raportimit instrumentat financiarë të Shoqërisë që mbartin interes ishin:

	<b>31 dhjetor 2020</b>	<b>31 dhjetor 2019</b>
<i>Instrumentat me interes të ndryshueshëm</i>		
Detyrime financiare	-	370,423,244
	<b>-</b>	<b>370,423,244</b>

**Analiza e ndryshueshmërisë së rrjedhës së parasë për instrumentat e ndryshueshëm**

Një ndryshim prej 100 pikë në normat e interesit në datën e raportimit do të kishte rritur (zvogëluar) fitimin ose humbjen me shumat e paraqitura më poshtë. Kjo analizë supozon që të gjitha variablat e tjerë, veçanërisht normat në monedhë të huaj, mbeten të pandryshuar.

	<b>Pasqyra e fitimit ose humbjes dhe të ardhurave të tjera gjithpërfshirëse</b>	
	<b>100 pikë Rritje</b>	<b>100 pikë Rënie</b>
<b>31 dhjetor 2020</b>		
Instrumentat me norma të ndryshueshme	-	-
<b>31 dhjetor 2019</b>		
Instrumentat me norma të ndryshueshme	3,704,232	(3,704,232)

**24.5 Ndryshimet në detyrimet që lindin nga anktiviteti financiar**

	<b>1 janar 2020</b>	<b>Flukset e parasë</b>	<b>Riklasifikimi i pjesës afatshkurtër</b>	<b>Pagesa e interesit</b>	<b>Deklarimi i dividendit</b>	<b>31 dhjetor 2020</b>
Kredi bankare dhe hua të tjera afatshkurtra	571,772,249	(1,317,334,416)	594,305,618	151,256,549	-	-
Huaja financiare afatshkurtër	8,971,406	(10,033,418)	9,886,652	1,062,012	-	9,886,652
Kredi bankare dhe hua të tjera afatgjata	594,305,618	-	(594,305,618)	-	-	-
Huaja financiare afatgjatë	19,962,071	2,380,357	(9,886,652)	-	-	12,455,776
Dividenti i pagueshëm	-	(30,940,000)	-	-	30,940,000	-
<b>Totali i detyrimeve nga aktiviteti financiar</b>	<b>1,195,011,344</b>	<b>(1,355,927,477)</b>	<b>-</b>	<b>152,318,561</b>	<b>30,940,000</b>	<b>22,342,428</b>

## **25. ANGAZHIME DHE PASIGURI**

### **Pasiguria e pretendimeve ligjore**

Në rrjedhën normale të aktivitetit, Shoqëria mund të përfshihet në çështje të ndryshme ligjore. Në datën e këtij raporti nuk ka çështje të rëndësishme ligjore të hapura kundër Shoqërisë të cilat kërkojnë rregullime apo paraqitje në pasqyrat financiare.

### **Garancitë**

Siç është paraqitur në shënimin 11, më 31 dhjetor 2019, Shoqëria ka një shumë 1,122,719 mijë Lek, e cila përfaqëson para të vendosura në Llogarinë Rezervë të Shërbimit të Borxhit dhe paratë e vendosura në Llogarinë Rezervë të investimeve Kapitale tek Alpha Bank, siç është përshkruar në seksionin 5.16 (c) të Marrëveshjes së Ndryshuar për Kushtet e Përbashkëta. Gjatë vitit 2020, Shoqëria ka paguar plotësisht vlerën e mbetur të huasë dhe llogaritë e ngurtësuara janë cliruar.

## **26. NGJARJE PAS PERIUDHËS RAPORTUESE**

Pas periudhës raportuese nuk ka ndodhur ndonjë ngjarje që mund të kërkojë rregullim në pasqyrat financiare.

Në mars 2021, Parlamenti i Shqipërisë aprovoi shtyrjen e Kontratës së Koncesionit deri në prill 2040. Ky ndryshim nuk ka efekt në pasqyrat financiare të vitit 2020.